



Studimet e shkallës së dytë-cikli i dytë

Tezë Magjistrature

“Analiza e treguesve financiarë si mjet për marrjen e vendimeve menaxheriale: Rasti i firmës “Meti-Komerc” për periudhën 2012-2016”

Kandidatja:

Flora Imeri

Mentori:

Prof. Inord. Dr. Fitim Deari

Tetovë, dhjetor, 2020

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT

Unë, Flora Imeri, me përgjegjësi të plotë deklaroj që ky punim me titull **“Analiza e treguesve financiar si mjet për marrjen e vendimeve menaxheriale: Rasti i firmës “Meti-Komerc” për periudhën 2012-2016”** përfaqëson punimin tim origjinal, është punuar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar më parë. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të civateve dhe referencave të tjera.

Flora Imeri

Tetovë, 2020

Lënda e hulumtimit

Pasqyrat apo bilancet financiare përpilohen dhe janë produkt i procesit kontabël dhe të njëjtat shfrytëzon më tej në vendimmarrjen, nga perspektiva afariste – menaxheriale etj. Gjithsesi, si të tilla (pra bilancet – informacioni kontabël) ato nuk do kishin vlerë në qoftë se nuk do të përdreshin më tej në funksion të vendimmarrjes, qoftë nga perspektiva e vetë entitet kontabël (menaxherët, pronarët) apo nga përdoruesit tjerë, si kreditorët, organet tatimore etj.

Të dhënat e pasqyruara apo raportuara në pasqyrat financiare kalojnë më tej në informacione si rezultat i përpunimit të tyre deri në fazën dhe momentin e vendimmarrjes menaxheriale. Pra, këto informacione do të duhet të shërbejnë për të përmirësuar gjendjen dhe performancën ekonomike dhe financiare të firmës (matur dhe shprehur shpesh përmes treguesve financiarë), për të kontrolluar të njëjtën.

Padyshim që në përpunimin dhe kalimin nga të dhënat kontabël në informacione kontabël shfrytëzohen një mori teknikash, metodash dhe metodologji nga analisti financiar. Këto përbëjnë atë që quhet apo njihet rëndom si analiza e pasqyrave financiare.

Duhet theksuar se marrja e vendimeve biznesore bazohet jo vetëm në informacione kuantitative, por edhe kualitative, madje jo vetëm financiare. Përdoruesit e informacionit duhet të kenë informacione të mjaftueshme sesi janë përpiluar raportet financiare dhe vendimmarrja duhet të gërshetoj edhe informacione jo vetëm nga sistemi kontabël.

Andaj, duke ndjekur studimet paraprake, por edhe me qëllime dhe pretendime që përfundimet e arritura në kuadër të këtij punimi të ndihmojnë vendimmarrjen afariste (rasti studimor) realizohen disa analiza dhe matje/llogaritje nga lënda e analizës së pasqyrave financiare.

Disa nga treguesit që rëndom përdoren në fushën përkatëse nga përdoruesit e ndryshëm përfshijnë: treguesit e likuiditetit, treguesit e raporteve të menaxhimit apo të aktiviteteve, treguesit e raporteve të borxhit, treguesit e rentabilitetit, treguesit e raportit të vlerës së firmës etj.

Pra, në këtë punim të masterit duke prezantuar rëndësinë, qëllimin dhe peshën që ka analiza e treguesve financiare si mjet dhe në funksion të vendimmarrjes menaxheriale, ne përpiqemi të studiojmë dhe paraqesim atë jo vetëm nga perspektiva teorike, por edhe përmes shembullit-rastit studimor konkret.

Hipotezat

Meqenëse hipotezat bashkë me pjesën e metodologjisë analizohen në kuadër të kreut të veçantë më vonë, këtu fillimisht radhiten dhe prezantohen në mënyrë më të përgjithshme që lexuesi të krijoj kuptim më analitik për ecurinë dhe rrjedhën e procesit hulumtues.

Hipotezat e këtij punimi janë:

$H1_0$ – Gjendja financiare e firmës “Meti Komerc” është përmirësuar gjatë periudhës 2012-2016.

$H1_a$ – Gjendja financiare e firmës “Meti Komerc” është përkeqësuar gjatë periudhës 2012-2016.

$H2_0$ – Performanca financiare e firmës “Meti Komerc” është përmirësuar gjatë periudhës 2012-2016.

$H2_a$ – Performanca financiare e firmës “Meti Komerc” është përkeqësuar gjatë periudhës 2012-2016.

$H3_0$ – Ekipi menaxhues “Meti Komerc” ka përdorur analizën e treguesve financiar në vendimmarrjen afariste gjatë periudhës 2012-2016 në funksion të përmirësimit të tyre.

$H3_a$ – Ekipi menaxhues “Meti Komerc” nuk ka përdorur analizën e treguesve financiar në vendimmarrjen afariste gjatë periudhës 2012-2016 në funksion të përmirësimit të tyre.

Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia e hulumtimit të këtij punimi ka të bëjë me identifikimin e objektivave, mjeteve dhe teknikave/metodave të përdorura, hapave që ndiqen deri në nxjerrjen dhe interpretimin e rezultatit.

Kuptohet, rezultatet e arritura ngelin të vlefshëm apo nuk kanë pretendime të përgjithësohen për subjekte tjera afariste për shkak të më shumë faktorëve brenda dhe jashtë biznesit që mund të ndikojnë (sipas rastit studimor).

Gjithashtu, vëzhgimi dhe analiza e të dhënave financiare dhe jo financiare për firmën “Meti Komerc”, Dobrosht-Tetovë përfshijnë periudhën 2012-2016. Pra, periudha është e kufizuar dhe të dhënat e zgjedhur nga firma “Meti-Komerc” janë të dhënat bazë në këtë punim të cilat përpunohen kryesisht përmes Excel-it.

Abstrakti

Qëllimi i kësaj teme magjistrature është të analizon treguesit financiar si mjet për marrjen e vendimeve menaxheriale. Studimi do të realizohet përmes rastit studimor, edhe atë në kuadër të firmës “Meti-Komerc” për periudhën 2012-2016.

Në këtë studim do të realizohet analiza e pasqyrave financiare të firmës “Meti-Komerc” Dobrosht dhe bëhet vlerësimi i ecurisë së biznesit. Përveç analizave dhe matjeve të zakonshme në fushën e analizës së pasqyrave financiare, në kuadër të studimit është realizuar edhe një pyetësor për të shqyrtuar përdorimin e informacionit kontabël në funksion të vendimmarrjes menaxheriale.

Studimi tregoi se në përgjithësi firma “Meti-Komerc” ka arritur të mbanë një trend përgjithësisht pozitiv të likuiditetit, por ngel shqetësues përkeqësimi i disa zërave bilancor, si dhe bllokimit i parasë. Më konkretisht, studimi tregoi një trend negativ të qarkullimit të inventarëve dhe se raporti mesatar vijues arrijnë 2.7 herë kundrejt testit acid mesatar prej 0.3.

Studimi më tej tregon se përdorimi më efikas dhe efektiv i aktiveve do të përmirësonte edhe më shumë treguesit financiarë, kryesisht ato që lidhen me përfitueshmërinë. Ndonëse të njëjtit sa vijnë edhe përmirësohen, për shembull, ROE në vitin e fundit arrijnë në 9% në krahasim me 6% vitin e parë të analizës.

Në vazhdim, studimi tregon se në aspekt të financimit firma ka përdor kryesisht kapitalin dhe se aktivet janë financuar mesatarisht me 31% detyrime. Kjo do të thotë se çdo 1,000 denarë aktive janë financuar me 310 denarë detyrime.

Në fund, analiza e të dhënave nga pyetësori tregoi se në përgjithësi menaxhimi i firmës është i njoftuar për rëndësinë e informacionit kontabël financiar në vendimmarrje. Por, ngel sfidë në të ardhmen që treguesit financiarë të përdoren nga vendimmarrësit e brendshëm të firmës më shpesh sesa në nivel vjetor. Gjithashtu, sistemi i raportimit financiar duhet të jetë në harmoni me kërkesat e vendimmarrësve të brendshëm të informacionit kontabël.

Fjalët kyçe: treguesit financiarë, ROA, ROE, firma “Meti-Komerc”.

Abstract

The purpose of this master thesis is to analyze financial ratios as a tool for managerial decision making. The study will be realized through the case study, also within the firm "Meti-Komerc" for the period 2012-2016.

In this study, the financial statements analysis of the firm "Meti-Komerc" Dobrosht will be performed and the progress of the business will be evaluated. In addition to the usual analysis and measurements in the field of financial statement analysis, the study also conducted a questionnaire to examine the use of accounting information for managerial decision-making.

The study showed that in general the firm "Meti-Komerc" has managed to maintain a generally positive liquidity trend, but remains worrying the deterioration of some balance sheet items, as well as the freezing of money. More specifically, the study showed a negative trend of inventory turnover and that the following average ratio reaches 2.7 times versus the average acid test of 0.3.

The study further shows that more efficient and effective use of assets would further improve financial ratios, mainly those related to profitability. Although the same are coming and improving, for example, ROE in the last year reaches 9% compared to 6% in the first year of the analysis.

In addition, the study shows that in terms of financing the firm has mainly used equity and that assets are financed on average with 31% liabilities. This means that every 1,000 denars assets are financed with 310 denars liabilities.

Finally, the analysis of the data from the questionnaire showed that in general the management of the firm is aware of the importance of accounting information in decision making. But, there remains a challenge in the future for financial ratios to be used by the firm's internal decision makers more often than on an annual basis. Also, the financial reporting system should be in line with the requirements of internal accounting decision makers.

Keywords: financial ratios, ROA, ROE, firm "Meti-Komerc".

Апстракт

Целта на овој магистерски труд е да ги анализира финансиските показатели како алатка за донесување на менаџерски одлуки. Студијата ќе се спроведе преку истражување на случајот, исто така во рамките на фирмата „Мети-Комерц“ за периодот 2012-2016 година.

Во оваа студија ќе се изврши анализа на финансиските извештаи на фирмата „Мети-Комерц“ Доброште и ќе се оцени одвивањето на работењето на бизнисот. Покрај вообичаената анализа и мерења во областа на анализа на финансиските извештаи, во рамките на студијата беше спроведен и прашалник за испитување на употребата на сметководствени информации во функција на донесување на менаџерски одлуки.

Студијата покажа дека генерално фирмата „Мети-Комерц“ генерално успеа да одржи позитивен тренд на ликвидност, но останува загрижувачки влошувањето на некои билансни гласини, како и замрзнувањето на парите. Поконкретно, студијата покажа негативен тренд на промет на инвентарот и дека следниот просечен однос достигнува 2,7 пати наспроти просечниот ацид тест од 0,3.

Студијата понатаму покажува дека поефикасно и поефективно користење на средствата дополнително ќе ги подобри финансиските индикатори, главно, оние поврзани со профитабилноста. Иако истите постојано се подобруваат, на пример, РОЕ во последната година достигнувала 9% во споредба со 6% во првата година на анализа.

Во продолжение, студијата покажува дека во однос на финансирањето, фирмата главно го користела капиталот и дека активите се финансираат во просек со 31% обврски. Ова значи дека на секои 1.000 денари активите се финансираат со 310 денари обврски.

На крај, анализата на податоците од прашалникот покажа дека генерално раководството на фирмата е свесно за важноста на информациите за финансиско сметководство при донесување одлуки. Но, останува предизвик во иднина финансиските индикатори да се користат од внатрешните донесувачи на одлуки во фирмата почесто отколку на годишно ниво. Исто така, системот за финансиско известување треба да биде во согласност со барањата на внатрешните донесувачи на одлуки на сметководствените информации.

Клучни зборови: финансиски показатели, РОА, РОЕ, фирмата „Мети-Комерц“.

Lista e tabelave:

Tabela 1: Bilanci i gjendjes 2012-2016.....	36
Tabela 2: Analiza strukturore e bilancit të gjendjes.....	37
Tabela 3: Trendi i zërave sipas analizës strukturore të bilancit të gjendjes 2012-2016.....	37
Tabela 4: Analiza vit pas viti e bilancit të gjendjes 2012-2016.....	39
Tabela 5: Trendi i zërave të bilancit të gjendjes 2012-2016	39
Tabela 6: Bilanci i suksesit 2012-2016	41
Tabela 7: Analiza strukturore e bilancit të suksesit 2012-2016.....	41
Tabela 8: Trendi i zërave sipas analizës strukturore të bilancit të suksesit 2012-2016	42
Tabela 9: Analiza viti pas viti e bilancit të suksesit 2012-2016	43
Tabela 10: Trendi i zërave sipas analizës dinamike të bilancit të suksesit 2012-2016.....	43
Tabela 11: Raporti vijues 2012-2016.....	45
Tabela 12: Norma e kesh-it	46
Tabela 13: Testi acid	47
Tabela 14: Raporti bruto fitim me shitjet neto.....	48
Tabela 15: Raporti fitimi neto me shitjet neto	49
Tabela 16: Norma e kthimit të aktiveve (ROA)	50
Tabela 17: Norma e kthimit të kapitalit (ROE)	51
Tabela 18: Qarkullimi i inventarit.....	52
Tabela 19: Qarkullimi i llogarive të arkëtushme	53
Tabela 20: Qarkullimi aktiveve gjithsej	54
Tabela 21: Raporti i borxhit gjithsej me aktivet gjithsej.....	55
Tabela 22: Raporti i borxhit me kapitalin gjithsej	56
Tabela 23: Përmbledhja e treguesve financiar	57
Tabela 24: Fitimi/humbja sipas bilancit të suksesit dhe bilancit tatimor	61

Tabela 25: Të dhënat e siguruarra për nivelin e arsimimit, profesionit dhe pozitën e tyre	62
Tabela 26: Përvoja e të punësuarve.....	63
Tabela 27: Njoha e konceptit të kontabilitet dhe përdorimi i bilanceve	64
Tabela 28: Përparësitë e treguesve financiarë dhe përdorimi i tyre	65
Tabela 29: Përdorimi i treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste	66
Tabela 30: Norma e kthimit të aktiveve dhe kapitalit (ROA dhe ROE)	67
Tabela 31: Perceptimi për gjendjen/performancën e firmës.....	68
Tabela 32: Disa zëra bilancor nga bilanci i suksesit	70

Lista e figurave:

Figura 1: Vendimmarrja afariste, përpunimi i autorit	22
Figura 2: Ndërtime nga firma Meti Komerc	30
Figura 3: Materialet për ndërtim si dhe pajisjet	31
Figura 4: Mjetet transportuese dhe mjetet për gërmime	32
Figura 5: Struktura menaxheriale e firmës Meti-Komerc	32
Figura 6: Trendi i zërave sipas analizës strukturore të aktiveve 2012-2016	38
Figura 7: Trendi i zërave sipas analizës strukturore të pasiveve 2012-2016.....	38
Figura 8: Trendi i aktiveve 2012-2016.....	40
Figura 9: Trendi i pasiveve 2012-2016	40
Figura10:Trendi i zërave sipas analizës strukturore të fitimit neto, shpenzimeve dhe të ardhurave 2012-2016.....	42
Figura 11:Trendi i fitimit neto, shpenzimeve dhe të ardhurave 2012-2016.....	43
Figura 12: Treguesit e likuiditetit - Raporti i aktiveve afatshkurtra me detyrimet afatshkurtra....	45
Figura 13:Treguesit e likuiditetit - Raporti ekuivalentët e kesh-it me aktivet afatshkurtra	46
Figura 14: Treguesit e likuiditetit - Testi acid	47
Figura 15: Treguesit e rentabilitetit - Raporti bruto fitim me shitjet neto.....	48
Figura 16: Treguesit e rentabilitetit - Raporti fitimi neto me shitjet neto	49
Figura 17: Norma e kthimit të aktiveve	50
Figura 18: Norma e kthimit të kapitalit	51
Figura 19: Qarkullimi i inventarit	52
Figura 20: Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme	53
Figura 21: Qarkullimi i aktiveve gjithsej	54
Figura 22: Raporti i borxhit gjithsej me aktivet gjithsej	55
Figura 23: Raporti i borxhit me kapitalin gjithsej.....	56
Figura 24: Fitimi/humbja sipas bilancit të suksesit dhe bilancit tatimor.....	61
Figura 25: Paraqitja grafike e nivelit të arsimimit, profesionit dhe pozita e tyre	63
Figura 26: Përvoja e të punësuarve	64
Figura 27: Paraqitja grafike për nocionin e kontabilitet dhe përdorimin e bilanceve.....	64
Figura 28: Njohja e treguesve financiarë dhe përdorimi e tyre	65

Figura 29: Paraqitja grafike e përdorimit të treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste	66
Figura 30: Norma e Kthimit të Kapitalit (ROE) dhe Norma e Kthimit të Aktiveve(ROA).....	67
Figura 31: Paraqitja grafike për përmirësimin/përkeqësimin e performancës	68

Përmbajtja

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT.....	2
Lënda e hulumtimit	3
Hipotezat.....	4
Metodologjia e hulumtimit	5
Abstrakti	6
Abstract	7
Анстракт	8
Lista e tabelave:	9
Lista e figurave:	11
Kreu 1: Hyrje	15
1.1 Rëndësia e punimit	15
1.2 Qëllimi i punimit	16
1.3 Identifikimi i problemit	16
Kreu 2. Rishikimi i literaturës	18
2.1. Përdoruesit e informacionit kontabël	18
2.2. Pasqyrat financiare si produkt i sistemit kontabël, disa koncepte teorike	19
2.3. Kuptimi dhe roli i treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste	21
2.4. Përparësitë dhe kufizimet e treguesve financiarë	23
2.5 Klasifikimi i treguesve financiarë.....	25
Kreu 3. Metodologjia e hulumtimit.....	29
3.1. Përshkrimi i firmës dhe burimet e të dhënave	29
3.2 Hipotezat	34
3.3 Metodologjia e hulumtimit.....	35
Kreu 4. Analiza dhe diskutimi i rezultateve	36
4.1 Qëllimet e analizës së treguesve financiarë – rasti studimor	36
4.2. Llogaritja dhe interpretimi i treguesve financiarë sipas klasifikimit tradicional.....	58
4.3. Llogaritja dhe interpretimi i treguesve financiarë sipas klasifikimit funksional.....	59
4.4. Analiza e bilancit tatimor dhe treguesit financiarë	60
4.5. Të dhënat dhe interpretimi i informacionit nga gjetjet e pyetësorit	62
4.6. Analiza me skenar dhe implikimi në vendimmarrjen menaxheriale	69

4.7. Përmbledhje, diskutimi dhe implikimi praktik i rezultateve	73
Kapitulli i 5. Përfundime, rekomandime dhe kufizimet e studimit.....	77
5.1 Përfundime dhe rekomandime.....	77
5.2. Kufizimet e studimit dhe hulumtimet e ardhshme.....	78
Referencat / Bibliografia:	79
SHTOJCAT:	81
A. Pyetësi.....	81
B. Bilanci i gjendjes 2012 – 2016	83
C. Bilanci i suksesit 2012 – 2016.....	85

Kreu 1: Hyrje

1.1 Rëndësia e punimit

Duke ndjekur punimet paraprake në këtë fushë ose të ngjashëm, edhe në këtë punim pretendohet të arrihen jo vetëm qëllimet akademike, por të sigurohet edhe një evidencë empirike dhe praktike me gjithë kufizimet që mund të ketë në kuadër të treguesve financiarë.

Fillimisht studimi përpiqet t'i identifikoj pikat të cilat paraqiten më me interes për firmën. Pra, ato pika problematike të cilët ndikojnë në mënyrë negative në rezultat, që më pas të mund të merren masa në parandalimin e tyre si dhe në eliminimin e tërësishëm të tyre përderisa është e mundshme. Andaj, edhe studimi përpiqet që t'u shërbejë si bazë për përmirësimin e performancës së firmës po ashtu edhe në zhvillime të mëtejshme.

Ky punim duke u mbështetur në pikëpamjen teorike, çfarë është bërë më herët nga të tjerët në fushën e treguesve financiar në kuptim të praktikave të mira, studion dhe prezanton sa dhe si analiza e treguesve financiar si pjesë e analizës së pasqyrave financiar shfrytëzohet si instrument i vendimmarrjes menaxheriale në funksion të përmirësimit të biznesit të firmës.

Kjo arrihet duke analizuar sesi ka ecur ndër vite gjendja ekonomike-financiare e firmës, cilat janë anët e forta dhe të dobëta të firmës, çfarë duhet bërë që të përmirësohet performanca financiare e firmës etj.

Ky do të jetë një studim jo vetëm teorik, por që nesër do të mund të shfrytëzohet edhe nga biznesi në fjalë si një aparat shkencor dhe praktik i analizës së treguesve financiar.

Çdo firmë madje ambient ekonomik-financiar, kulturor etj., ku ajo vepron është unik. Pra, nuk ka receta të gatshme-strikte si të përmirësojmë biznesin, por duke u udhëhequr nga parimet dhe praktikat e njohura dhe të mira, do të mundohemi që ato t'i reflektojmë tek biznesi në fjalë përmes dhënies së sugjerimeve/rekomandimeve.

Njëherë, ky studim do të nxjerrë në sipërfaqe problematikën jo vetëm të përlllogaritjes së treguesve financiar, por edhe të interpretimit konkret të tyre. Po ashtu një rol të rëndësishëm e luajnë edhe implikimet të cilat paraqiten nga fusha kontabël-ligjore në këtë rast bilanci tatimor të cilët kanë një rëndësi në vendimmarrjen afariste. Andaj, do të prezantohet shembulli konkret nëse këto ndryshime janë prezent edhe në këtë rast studimor.

1.2 Qëllimi i punimit

Ky punim magjistrature, paraqet rolin dhe rëndësinë e përdorimit të treguesve financiar për përmirësimin e ecurisë, gjendjes dhe performancës duke prezantuar shembullin – rastin studimor konkret.

Qëllimi i këtij punimi magjistrature është që t'u ofrojë një evidencë hulumtuese të ardhshëm në lidhje me zbatimin praktikë të analizës së treguesve financiar përmes subjektit konkret afarist në marrjen e vendimeve menaxheriale.

Rëndësia e përdorimit të treguesve financiarë në kuadër të këtij hulumtimi nuk prezantohet apo trajtohet vetëm nga perspektiva akademike, por pretendohet të vendohet në funksion të përmirësimit të treguesve financiarë nga subjekti i përzgjedhur për analizë.

Qëllimet e hulumtimit të këtij studimi do të identifikohen, hulumtohen dhe realizohen edhe përmes pyetjeve karakteristike si në vijim:

- Cila është gjendja dhe performanca financiare e subjektit për periudhën e analizuar?
- Vendimmarrësit dhe në radhë të parë menaxherët a interesohen për gjendjen dhe performancën financiare të subjektit?
- Menaxherët a përdorin treguesit financiarë në vendimmarrje, cila është evidenca empirike dhe çfarë tregojnë treguesit financiarë: a kemi përmirësim apo përkeqësim të subjektit?
- Cilat janë ato faktorë të cilat kanë ndikuar pozitivisht apo negativisht në gjendjen/performancën dhe treguesit financiarë të firmës në fjalë?

1.3 Identifikimi i problemit

Pronarët respektivisht aksionarët e firmës janë përdorues informacioni mjaft të interesuar për të ditur rrjedhën e pasurisë së tyre të investuar në biznes. Ato interesohen për ecurinë e biznesit, problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet biznesi dhe për shumë çështje të tjera që lidhen me përmirësimin e treguesve financiarë.

Padyshim që janë edhe menaxherët e firmës ato të cilët i lexojnë dhe përdorin treguesit financiarë në vendimmarrje. Kuptohet, në përpunimin e të dhënave kontabël në informacione kontabël përdoren një numër i madh teknikash/metodash dhe metodologji të ndryshme nga analisti financiar dhe këto përbëjnë atë që quhet analiza e pasqyrave financiare.

Problemi i cili parashtrohet në aspektin praktik është sesa përdoruesit i përdorin këto teknika apo metoda të analizës së pasqyrave financiare në funksion të vendimmarrjes. Padyshim që t'i kuptosh dhe t'i analizosh të gjitha ose shumicën e raporteve financiare nuk është gjë e thjeshtë dhe e lehtë.

Andaj, identifikimi i problemit në këtë studim do të bazohet kryesisht në atë se në realitetet cila është gjendja e përdorimit të treguesve financiarë në funksion të vendimmarrjes menaxheriale. Problemi do të parashtrohet duke përdorur qasjen e analizës së treguesve të përzgjedhur për periudhën 2012-2016, pra duke analizuar të dhënat kontabël nga perspektiva empirike. Kështu do të nxirren disa sugjerime/rekomandime të mundshme në drejtim të përmirësimit të gjendjes dhe performancës financiare.

Krahas përlllogaritjes dhe diskutimit të treguesve financiarë (sipas përzgjedhjes në këtë studim) do të zbatohen edhe disa analiza siç janë:

- Analiza strukturore dhe dinamike,
- Analiza e bilancit të suksesit,
- Analiza e bilancit të gjendjes,
- Krahasimi i zërave të përzgjedhur nga bilanci i suksesit dhe bilanci tatimor,
- Analiza me skenarë dhe implikimet në vendimmarrje menaxheriale,
- Analiza e trendit,
- Analiza dhe diskutimi i gjetjeve nga pyetësi etj.

Të gërshetuar së bashku këto teknika dhe metoda do të prezantohen si gjetje të punimit se ku devijon firma (problemi për analizë: gjendja dhe performanca financiare, treguesit financiarë dhe përdorimi i tyre) shqyrtuar për analizë në kuadër të punimit.

Nga përdorimi dhe interpretimi i analizës së pasqyrës financiare të firmës për periudhën 2012-2016 do t'i mundësohet menaxherit të firmës "Meti-Komerc" Dobrosht që të njihet me treguesit financiarë dhe çfarë mund të ishte bërë më shumë në këtë drejtim si për periudha afatshkurtra ashtu edhe marrjen e vendimeve në periudha afatgjata.

Kreu 2. Rishikimi i literaturës

2.1. Përdoruesit e informacionit kontabël

Çdo individ, entitet apo institucion në jetën e përditshme përballen me marrjen e vendimeve të ndryshme. Miratimi dhe vlerësimi i këtyre vendimeve do të duhet të bazohet në informacion sasior dhe cilësor.

Gjithsesi, kemi një gamë të gjerë të përdoruesve të pasqyrave financiare, pra grupe të ndryshme të cilët janë të interesuar në aspektin financiar të firmës. Edhe atë, këto përdorues sipas autorit Wild ndahen në dy grupe përdoruesish të pasqyrave financiare: të brendshëm dhe të jashtëm, ku përdoruesit e brendshëm të informacionit janë ato individë të përfshirë në administrimin dhe operimin e firmës. Ku disa nga përdoruesit e brendshëm janë menaxherët, auditorët e brendshëm, konsulentët dhe shumë vendimmarrës tjerë të rëndësishëm. Si dhe arsyeja e përdorimit të pasqyrave financiare për këto përdorues është marrja e informacionit të dobishëm për efikasitetin dhe efektivitetin e firmës. Kurse, përdoruesit e jashtëm të informacionit kontabël nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në kompani dhe disa nga ato janë: aksionarët, klientët, furnitorët, kreditorët etj.¹

Kuptohet se vendime të ndryshme kanë edhe kosto/përfitime të ndryshme varësisht nga shkalla dhe lloji i riskut përcjellës. Një vendimmarrje e bazuar në informacione qoftë nga kontabiliteti apo burime të tjera brenda dhe jashtë firmës pritet të jetë më e saktë dhe e drejtë krahasuar me një vendimmarrje tjetër që bazohet në intuitën afariste apo menaxheriale.

Mënyra e marrjes së vendimeve është një moment i rëndësishëm, po ashtu lloji i vendimeve dhe koha në të cilën do të merren vendimet duhet marrë në konsideratë. Ky proces duhet të përgjigjet në arritjen e qëllimeve afatgjata apo qëllimeve afatshkurtra të biznesit. Normalisht se për të marrë vendime duhet që pikë së pari të kemi informacione të sakta, në kohë, të besueshme etj. dhe këto informacione mund t'i sigurojmë nëpërmjet kontabilitetit.

Pra, siç dihet kontabiliteti është një shërbim i cili ofron informatat e nevojshme për miratimin e vendimeve menaxheriale, pasi paraprakisht informatat e grumbulluara i ka përpunuar në përmbajtje, dhe formë adekuate ua ka prezantuar subjekteve të interesuara nëpërmjet raporteve financiare.²

¹ John J. Wild, Financial Accounting information for decision, Mc Graw-Hill, 2000, fq. 662.

² Rufi Osmani, Kontabiliteti Menaxherial për biznes, Tetovë, 2011, fq. 5.

Padyshim që ekzistojnë ndarje të ndryshme sa i përket përdoruesve të informacionit kontabël. Për shembull, Dharmo (2005) bënë këtë ndarje të përdoruesve të informacionit kontabël edhe atë:³

- **Investitorët:** Janë ato persona të cilët janë të interesuar për informacionin kontabël sepse ato marrin pjesë në pasurinë e firmës.
- **Kreditorët:** Janë përdoruesit e jashtëm të informacionit.
- **Të punësuarit:** Janë përdorues të informacionit që interesohen për kushtet e punës dhe pagat/rrogat, shpërblimet etj.
- **Furnitorët:** Janë përdorues të jashtëm të informacionit.
- **Klientët:** Kërkojnë të dinë mbi vazhdimësinë e kompanisë se a është vend i sigurt prej nga furnizohen e veçanërisht kur ato kanë një përfshirje afatgjate.
- **Qeveria dhe agjencitë e saj:** Ato gjithashtu janë të interesuar për aktivitetin e kompanisë. **Publiku:** Pasqyrat financiare mund të ndihmojnë publikun në përfitimin e informacionit mbi zhvillimet aktuale në prosperitetin e njësisë ekonomike dhe të një mase të aktiviteteve.

Pra, për të pasur një drejtim efikas të njësisë ekonomike (firmës) hapi i parë që duhet të merret është pikërisht shqyrtimi i informacionit kontabël dhe financiarë. Siç kemi cekur edhe më lartë kemi një numër të madh të përdoruesve të informacionit financiarë dhe kontabël në vendimmarrje dhe ato grupohen në varësi të interesave si përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Po ashtu autori Deari (2007) ka cekur se kemi një grup të cilët janë të interesuar për pasqyrat financiare edhe atë grupi i konsumatorëve, klientët dhe publiku i gjerë.⁴

2.2. Pasqyrat financiare si produkt i sistemit kontabël, disa koncepte teorike

Kontabiliteti është një sistem nëpërmjet të cilit ne mund të sigurojmë informacione të mjaftueshme, duke e ditur se roli i tij është që t'i përpunoj të dhënat, analizojnë e më në fund t'i paraqes në formë të pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare bëhen jo vetëm si kërkesë ligjore, por edhe përpilohen në atë mënyrë që firma të mund t'i përdorë gjatë marrjes së vendimeve. Mirëpo vendimmarrja mund të jetë si brenda ashtu edhe jashtë firmës. Për shembull, vendimmarrësi – kontrolli financiarë i analizon raportet financiare për të parë nëse ato janë konform kërkesave ligjore kontabël, por edhe

³ Për më shumë shih: Sotiraq M. Dharmo, Kontabiliteti i avancuar, Tiranë, 2005, fq. 73 - 74.

⁴ Për më shumë shih: Fitim Deari, Parimet e kontabiliteti financiar, Tetovë, 2007, fq. 61 - 65.

menaxheri siç prezantuar më lartë paraqitet si vendimmarrës. Pra, të gjithë përdoruesit i shfrytëzojnë pasqyrat financiare për vendime të ndryshme si: afariste, financiare, investuese, financuese, ligjore etj.

Pyetja rëndom që parashtrohet në këtë drejtim dhe më tej është se çfarë mund të presim nga analiza e pasqyrave financiare? Analiza e pasqyrave financiare është një sferë interesante për t'u studiuar pasi që na mëson mënyrën e funksionimit të shumë dukurive –implikimeve të cilat kanë ndikim në vendimet e firmës me të cilën ballafaqohet ajo çdo ditë.

Duke analizuar shifrat apo treguesit financiarë, ne kuptojmë sesi funksionon firma, çfarë lloje politikash janë përdorur, si është gjendja e saj financiare – ekonomike, fluksin e parave të nevojshme për zbatimin e vendimeve, nivelin e financimit dhe investimeve etj.

Pra, analiza e pasqyrave financiare studion pjesën më të ndjeshme të firmës edhe atë duke u nisur nga bilanci i gjendjes, bilanci i suksesit, analiza e rrjedhës së parasë, analizën e bilancit tatimorë si dhe analiza të tjera të treguesve financiar të cilat janë të lidhura me vendimmarrjen. Andaj, mund të themi analiza e pasqyrave financiare bëhet për të pasur një pasqyrë më reale të firmës për t'i parë avantazhet dhe disavantazhet e saj, për të ditur gjendjen dhe performancën financiare dhe për t'u përdorur më tej në funksion të vendimmarrjes menaxheriale.

Rëndom, pasqyrat apo bilanci financiare janë përmbledhje dhe tregojnë veprimtarinë, financimin dhe investimin e një biznesi – firme. Andaj, ato duhet të sigurojnë informacion të dobishëm për investitorët dhe kreditorët (krahas përdoruesve të tjerë), dhe kjo dobi do të thotë që investitorët dhe kreditorët mund të përdorin informacionin për të parashikuar, krahasuar dhe vlerësuar shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parave.⁵

Më tej, autori Xhafa (2005) thekson se: “për të gjetur drejtimin e dëshiruar shpesh pasqyrat financiare janë harta, në bazë të së cilës në qoftë se harta nuk i përmban të gjitha shenjat dhe elementet e nevojshme, përdoruesi i sajë nuk mund të gjejë atë që kërkon. Pra, pasqyrat financiare kanë cilësinë të jenë njëkohësisht një mjet udhërrëfyes për drejtimin e shoqërisë, por në ndërkohë lënë shteg për një sërë interpretimesh, në varësi të llojit të informacionit të përfshirë dhe mënyrës së trajtimit të tij.”⁶

⁵ Për më shumë shih: Pamela Peterson Drake, Frank J. Fabozzi, Analysis of Financial Statement, Third Edition, 2012, fq. 37 – 61.

⁶ Halit Xhafa, Analiza e Pasqyrave Financiare, Tiranë, 2005, fq. 1.

2.3. Kuptimi dhe roli i treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste

Duke pasur parasysh se zhvillimet në kohën e fundit, rasti i COVID-19 i ka shqetësuar pronarët e kompanive dhe po ashtu menaxherët ndeshen me situata të vështira. Andaj, kjo ka bërë që vendimmarrjes t'i kushtohet një rëndësi e veçantë.

Pra, mjetet/metodat dhe informacionet të cilat mund ta ndihmojnë atë dhe sidomos tani në funksion të menaxhimit më të suksesshëm të firmës do të ishin të mirëseardhura. Andaj, tani dhe tradicionalisht kohë më parë për të ulur nivelin e riskut dhe për të vendosur në kushtet e pasigurisë menaxherët përdorin treguesit financiar me gjithë kufizimet që mund të kenë.

Historikisht, raportet financiare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në vlerësimin e performancës dhe gjendjes financiare të një njësie ekonomike (biznesit). Gjatë viteve, studimet empirike në fushën e analizës së pasqyrave financiare kanë demonstruar vazhdimisht dobinë dhe rëndësinë që kanë treguesit financiarë.⁷

Rritja e sigurisë në vendimmarrje pritet të vijë nga informacione brenda ose jashtë biznesit, nga pasqyrat financiare edhe atë nga analiza e treguesve financiarë etj. Këto të fundit ndihmojnë në rritjen e sigurisë së vendimmarrjes, pra duke u mundësuar informacione të hollësishme mbi firmën dhe vlerësimin e gjendjes së saj në kohë dhe në periudha të caktuara.

Roli i treguesve financiarë është thelbësor në vendimmarrjen menaxheriale duke mundësuar krahasimin e të dhënave ndër vite, po ashtu firmën për analizë me degën/normat etj.

Treguesit financiarë na ndihmojnë të përgjigjemi në disa pyetje edhe atë:

- Pse është një firmë më me përfitime apo më pak përfitime sesa tjetra?
- Cilat janë pritjet nga investimet e bëra të firmës dhe cili është risku përkatës?
- A do të jetë firma në gjendje t'i shlyej detyrimet në kohë?
- A i përdor në mënyrë të duhur firma mjetet e saja dhe cili është efikasiteti etj.?

Gjithsesi treguesit financiarë do të llogariten dhe interpretohen nëse disponohen të dhëna dhe informacione. Shumë tregues financiarë për një kategori të caktuar të bizneseve nuk mund të llogariten sepse analisti apo vendimmarrësi nuk disponon të dhënat kontabël, bie fjala, firma nuk përgatitë raportin e parasë.

⁷ Për shembull, për më shumë shih: Kung H. Chen and Thomas A. Shimerda, Financial Menagment: Journal Article, An Empirical Analysis of Useful Financial Ratios, Spring 1981, Vol. 10, No. 1, fq. 51-60. [Online]

Zakonisht, një kategorie veçantë e bizneseve (për shembull, por jo vetëm, rasti i kompanive të renditura në Bursën e letrave me vlerë të Maqedonisë së Veriut) përpilojnë disa raporte ose pasqyra financiare si:

- Bilanci i gjendjes,
- Bilanci i suksesit,
- Pasqyra e ndryshimeve në kapital,
- Pasqyra cash-flow,
- Raporti i të dhënave të veçanta (i njohur si shtojcat) etj.




Figura 1: Vendimmarrja afariste, përpunimi i autorit.

Bilancet tjera si raporti i TVSH-së, bilanci tatimor, të dhënat për raportim të brendshëm, ose që lidhen me sektorin/degën etj. janë me rëndësi në llogaritjen dhe interpretimin e treguesve financiarë nga perspektiva e vendimmarrësit.

Figura 1 prezenatn një ilustrim të thjeshtëzuar të përdorimit të informacionit kontabël dhe financiarë. Andaj, informacioni në drejtimin-menaxhimin e një firme si dhe në vendimmarrjen afariste luanë një rol tejet të veçantë, sepse ai mundëson që të gjithë të interesuarit të orientohen dhe të marrin vendime të duhura. Një nga informacionet që përdorin drejtuesit e njësive ekonomike është pikërisht informacioni kontabël dhe financiarë.

Siç ka cekur edhe autori Sotiraq. M. Dharmo (2005) se roli i kontabilitetit në drejtimin e një njësie ekonomike është i madh sepse ai siguron drejtimin e njësisë ekonomike, ai po ashtu siguron informacion të shkruar, të saktë dhe rigorozisht të dokumentuar mbi gjendjen financiare,

mbi sukseshmërinë e saj dhe duke i përfshirë të gjitha ata faktorë të cilat kanë ndikuar negativisht apo pozitivisht në ndryshimet e firmës gjatë një periudhe. Karakteristikën e informacionit kontabël dhe financiar, që e bëjnë të vlefshëm për përdoruesit në vendimmarrje është pikërisht: kuptueshmëria, rëndësia, besueshmëria, krahsimi etj.

Kuptohet, që qëllimi tradicional që ka kontabiliteti zërthehet në atë se sa e rëndësishëm është (vendimmarrja), të diagnostifikohet dhe vlerësohet gjendja ekonomike dhe financiare e subjektit kontabël – kompanisë.⁸

Po ashtu, janë disa studime teorike dhe praktike që kanë trajtuar treguesit financiarë nga perspektiva të ndryshme të analizës. Për shembull, autorët Babalola dhe Abiola (2013) në punimin e tyre trajtojnë marrëdhënien në mes analizës financiare dhe kontabilitetit.⁹

2.4. Përparësitë dhe kufizimet e treguesve financiarë

Nëse dëshirojmë të krahasojmë apo të gjejmë një trend i cili na nevojitet për t'i kuptuar pasqyrat financiare, atëherë analiza e raporteve ose treguesve financiarë është mjet i dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare, qoftë të brendshëm ose të jashtëm. Në qoftë se bëhet siç duhet analiza e raporteve ajo mundëson që ta kuptojmë më mirë efikasitetin dhe efektivitetin e firmës dhe si po zhvillohet biznesi, cili është trendi, mundësitë dhe riskun etj.

Kemi shumë tregues financiarë për të vlerësuar gjendjen dhe performancën financiare të një firme, mirëpo pavarësisht treguesve të cilat i përdorin menaxherët apo edhe gjatë procesit të krahasimit financiar të dy apo më shumë firmave ato kanë përparësitë dhe kufizimet e tyre.

Në vazhdim do të cekim disa përparësi dhe kufizime të treguesve financiarë.

Përparësitë e treguesve financiarë

- Përparësi e treguesve financiarë është se ato janë të ndërtuar në atë mënyrë për të ndihmuar në vlerësimin e pasqyrave si dhe për të ndihmuar në parashikimin e të ardhurave.¹⁰ Më tej, autorët Xhafa dhe Ciceri (2004) theksojnë se: “nga këndvështrimi i investitorëve, parashikimi i të ardhmes është i vetmi funksion i analizës së pasqyrave financiare, ndërsa nga këndvështrimi i menaxherëve, analiza e pasqyrave financiare përdoret edhe për të ndihmuar në parashikimin e situatave të

⁸ Për shembull, shih studimin dhe diskutimin e Maria Berheci, (2008), The Annual Reports and Financial Decisions, Annales Universitatis Apulensis Series Oeconomica, 2008, Vol. 1, Issue 10. [Online]

⁹ Y.A. Babalola dhe F.R. Abiola (2013), Financial Ratio Analysis of Firms: A Tool for Decision Making", International Journal of Management Sciences, 2013, Vol. 1, Issue 4, f. 132-137. [Online]

¹⁰ Halit Xhafa, Analiza e pasqyrave financiare, Tiranë, 2005, fq. 217.

ardhshme dhe çka është më e rëndësishme, si pikënisje për planifikimin e veprimeve që do të përmirësojnë performancën e ardhshme të shoqërisë.”¹¹

- Mund të shërbejnë si tregues për pikat e dobëta dhe të forta të firmave në fusha të caktuara dhe mund të zbulojnë çështje të cilat kërkojnë vëzhgim të mëtejshëm, pra nëpërmjet këtij informacioni mund të kuptojmë shumë për kërcënimet aktuale ku mund të marrim masa për eliminimin apo parandalimin e tyre po ashtu mund të shohim edhe mundësit të cilat i ka firma të cilat do të mundësojnë që firma të ketë rezultate edhe më të mira, pra mundëson që të bëjmë analizën swot.¹²
- Ndhimojnë për të kuptuar efikasitetin e vendimeve: Analiza e raporteve u mundëson vendimmarrësve të marrin llojin e duhur të vendimeve, se në cilët degë industriale firma duhet të veprojë, a duhet ajo të ushtrojë një aktivitet apo më shumë aktivitete ekonomike? A duhet firma të prodhon një produkt apo shërbim ose të prodhojë më shumë? Pra, analiza e raporteve na mundëson të kuptojmë nëse firma ka marrë llojin e duhur të vendimeve.¹³
- “Raportet ndihmojnë në thjeshtësimin e shifrave komplekse të kontabilitetit dhe nxjerrjen e marrëdhënieve të tyre. Pra, ato ndihmojnë në përmbledhjen e informacionit financiar në mënyrë efektive dhe vlerësimin e efikasitetit menaxherial, vlefshmërinë e kredisë së firmës, fitimin, kapacitetin etj.”¹⁴

Kufizimet e treguesve financiarë

Edhe pse raportet financiare ofrojnë një metodë më të shpejtë dhe më të lehtë për ta analizuar performancën ose gjendjen e një biznesi ato mund të japin të dhëna – rezultate për të njëjtat mirëpo ato nuk mund të përcaktojnë nëse performanca është e mirë apo e keqe. Andaj, gjatë interpretimit të raporteve duhet pasur kujdes të veçantë dhe se ato nuk janë pa kufizime.

Disa nga kufizimet e treguesve financiarë janë si vijon:

- “Shumë shoqëri të mëdha operojnë në industri të ndryshme dhe për shoqëri të tilla është e vështirë të sigurosh një grup tipik mesataresh industrie. Si rrjedhim analiza e raporteve është më e përdorshme për shoqëri të vogla me gamë të vogël produktesh sesa për ato të mëdha dhe shumë të diversifikuara.

¹¹ Halit Xhafa, Beshir Ciceri, Drejtimi financiar, Tiranë, 2004, fq. 136.

¹² Halit Xhafa, Analiza e pasqyrave financiare, Tiranë, 2005, fq. 217.

¹³ Fitim Deari, Parimet e kontabilitetit financiar, Tetovë, 2007, fq. 65.

¹⁴ Accounting Ratios – Accountancy: Company Accounts and Analysis of Financial Statements, <https://ncert.nic.in/ncerts/l/leac205.pdf>. [Online]

- Shumë shoqëri duan të jenë më të suksesshme se mesatarja e industrisë kështu që krahasimi me performancën e mesatares nuk është i mirë. Si synim një nivel performance më i lartë, është më mirë të fokusoheni tek raportet e liderëve të industrisë.
- Faktorët stinorë mund ta çrregullojnë analizën e raporteve. Ndikimi i tyre mund të zbutet duke përdorur mesataren mujore të inventarëve dhe të llogarive të arkëtueshme kur llogarisim raportet e qarkullimit.
- Është e vështirë të përgjithësohesh nëse një raport është i mirë apo i keq. Për shembull një raport i lartë korent mund të tregojë një pozicion të formë likuiditeti, që është mirë, ose para të tepërta që është keq sepse para të tepërta në bankë janë aktive jo përfituese. Në të njëjtën mënyrë, raporti i lartë i qarkullimit të aktiveve të qëndrueshme, qarkulluese mund të tregojë se një shoqëri që i përdorë aktivet e saja në mënyrë efektive ose një shoqëri është nën kapitalin normal dhe nuk mund të blejë aktive të mjaftueshme.
- Shoqëria mund të ketë disa raporte që duken të “mira” dhe të tjera që duken “të këqija” duke e bërë të vështirë të themi nëse shoqëria është në ekuilibër, e fortë apo e dobët.”¹⁵
- Një kufizim tjetër do të kishim cekur se të dhënat e siguruar nga raportet mund të sigurojnë informacion në një moment kohe të caktuar dhe jo për pritjet e ardhshme.¹⁶
- Analiza e raportit (treguesve) financiar e ndihmon analistin apo vendimmarrësin për të pasur një pasqyrë mbi firmën, mirëpo gjithashtu ajo është e orientuar drejt së kaluarës pa një kuptim më të thellë të biznesit, kuptimi i dinamikës së industrisë dhe tregjeve ku operon firma.¹⁷

2.5 Klasifikimi i treguesve financiarë

Treguesit financiarë mund të klasifikohen në grupe të caktuara dhe secila prej tyre reflekton në mënyrë të veçantë pozitën ose performancën financiare. Për t'i llogaritur këto tregues përdoren pasqyrat financiare dhe kështu analizohen anët e forta dhe të dobëta, përfshirë

¹⁵ Halit Xhafa, Beshir Ciceri, Drejtimi financiar, Tiranë, 2004, fq. 160-162.

¹⁶ Halit Xhafa, Drejtimi financiar, Tiranë, 2005, fq. 91.

¹⁷ Schönbohm, Avo (2013), Performance measurement and management with financial ratios: the BASF SE case, Working Paper, No. 72, Hochschule für Wirtschaft und Recht Berlin, IMB Institute of Management Berlin, fq. 20, <https://www.econstor.eu/bitstream/10419/74345/1/746339143.pdf>. [Online]

edhe rastin studimor në kuadër të këtij punimi të magjistraturës, pra firmës “Meti-Komerc”. Andaj, llogariten dhe interpretohen treguesit financiarë edhe atë si vijon.

Treguesit e likuiditetit: Likuiditeti i firmës tregon aftësinë e firmës për t’i shlyer detyrimet e saja afatshkurtra, pra a do mundet firma t’i shlyejë detyrimet afatshkurtra kur vjen afati i shlyerjes-pagesës së tyre.¹⁸ Gjatë analizës së likuiditetit do të mund të tregojmë sesi është raporti i aktiveve dhe i detyrimeve afatshkurtra të firmës gjatë viteve dhe do të bëhet krahasimi i tyre për të parë a është në rritje apo në rrënje. Treguesi i likuiditetit llogaritet nëpërmjet këtyre raporteve:

- **Raporti vijues:** Raporti vijues llogaritet si aktivet afatshkurtra në raport me detyrimet afatshkurtra dhe ky raport matë aftësinë e firmës për t’i përmbushur detyrimet e saja afatshkurtra mirëpo duke i përdorur vetëm aktivet e saja.¹⁹ Aktivet të cilat përbëhen nga asete të cilat lehtë mund të shndërrohen në para si dhe detyrimet afatshkurtra të cilat përbëhen nga pagesa të cilat duhet t’i bëjë firma në të ardhmen. Në qoftë se firma ka një rritje të këtij koeficienti mund të themi se ajo mund të paguajë borxhet pa asnjë pengesë. Që të interpretohet kuptimi i këtij raporti duhet që të vlerësohet likuiditeti i firmës për një periudhë më të gjatë, po ashtu duhet edhe të krahasohet me konkurrentët e industrisë.²⁰
- **Norma e kesh-it:** Ky raport llogaritet si kesh-i plus ekuivalentët e kesh-it dhe fondet tregtuese në raport me detyrimet afatshkurtra. Ky raport i përfshinë pasuritë më likuide të firmës të cilat janë mjetet monetare dhe financiare të cilat përfaqësojnë shumën e likuiditeteve të gjeneruar nga operationet e shoqërisë.²¹ Nëpërmjet këtij raporti ne mund të analizojmë në qoftë se norma e kesh-it është në rritje apo në rrënje. Në qoftë se firma ka tendencë rritëse të kesh-it atëherë një nga arsyet mund të jetë që firma ka bërë uljen e kërkesave dhe transformimin e tyre në mjete monetare.
- **Testi-Acid:** Ky tregues llogaritet kur nga aktivet qarkulluese minusohen inventarët dhe shpenzimet e parapaguara pra merren parasysh vetëm aktivet më likuide në raport me detyrime afatshkurtra.²² Nga vet fakti se ky raport i minuson inventarët mund të themi se është raporti më i shpejtë për ta parë aftësinë e likuiditetit të firmës, ngase duke e ditur se

¹⁸ Halit Xhafa, Analiza e pasqyrave financiare, Tiranë, 2005, fq. 216.

¹⁹ Po aty, fq. 217.

²⁰ Po aty, fq. 218.

²¹ Po aty, fq. 221.

²² Halit Xhafa, Drejtimi financiarë, Tiranë, 2005, fq. 72.

inventarët kanë një likuiditet përgjithësisht të ulët. Nga kjo kuptojmë se shitja e tyre është e vështirë, e cila mund të çojë edhe në ulje të çmimeve, po ashtu edhe gjetja e blerësve është e vështirë. Nëse kemi një nivel të lartë të këtij treguesi atëherë firma ka më shumë likuiditete afatshkurtra, mirëpo në qoftë se kemi një nivel të ulët të këtij treguesi atëherë do të tregonte se firma ka vështirësi në përmbushjen e detyrimeve aktuale. Vlen të cekim edhe se testi acid është më i saktë se sa raporti vijues. Ai e adreson firmën që t'i shlyej detyrimet e saja aktuale, në rast të rënies se të ardhurave, ose vështirësive tjera.²³

Treguesit e rentabilitetit: Ky tregues ka të bëjë me aftësinë e firmës për t'i kthyer paratë e shitjeve në fitime dhe llogaritet nëpërmjet raporteve si:

- **Fitimit marginal bruto:** Nëpërmjet këtij raporti firma mund të analizoj fitimet të cilat i ka realizuar nga shitja mirëpo pasi i ka paguar shpenzimet. Normalisht kuptohet sesa më i lartë të jetë ky raport mundësit për fitime janë më të larta.²⁴
- **Fitimi marginal neto:** Ky raport llogaritet si të ardhurat neto në raport me shitjet neto. Ky raport i matë të ardhurat të cilat vijnë nga shitja mirëpo duke i marrë në konsideratë të gjitha shpenzimet përfshirë interesin, tatimet dhe zërat jooperativë.²⁵
- **Kthimi nga aktivet (ROA):** Ky raport llogaritet si të ardhurat neto në raport me aktivet gjithsej. Nëpërmjet këtij raporti ne mund të tregojmë se a i menaxhon mirë firma përdorimin e burimeve të saja për të siguruar fitim, pra aksionarët kanë nevojë të llogarisin përfitimet e firmës.²⁶
- **Kthimi mbi kapitalin e vet (ROE):** Llogariten të ardhurat neto në raport me kapitalin e vet. Aksionarët janë të interesuar të dinë se sa fitim ka realizuar firma nga investimi i tyre në kapital, pra ato investojnë për të krijuar fitim nga paratë e tyre dhe ky tregues u tregon atyre se sa mirë po shkon investimi i tyre.²⁷

Efikasiteti i menaxhimit të aktiveve:

- **Raporti i qarkullimit të inventarit:** Ky raport llogaritet si kostot e mallrave të shitura në raport me inventarët. Ky raport e matë efikasitetin e shoqërisë, drejtimin dhe shitjen e

²³ Edward J. McMillan CPA, CAE, Not-for-Profit Budgeting and Financial Management, Fourth Edition, June 2010, fq. 180.

²⁴ Halit Xhafa, Analiza e pasqyrave financiare, Tiranë, 2005, fq. 229.

²⁵ Halit Xhafa, Drejtimi financiarë, Tiranë, 2005, fq. 82.

²⁶ Po aty, fq. 83.

²⁷ Po aty, fq. 83-84.

inventarit. Në qoftë se ky raport ka një nivel të lartë atëherë menaxhimi është efikas dhe fitimi në kompani do jetë më i lartë, mirëpo në qoftë se kemi një qarkullim tejet të lartë atëherë kjo vjen si pasojë e uljes së çmimit apo rritjes së kërkesës për shërbime në treg, si dhe e kundërta në qoftë se kemi një nivel të ulët të qarkullimit të inventarit atëherë mund të themi se firma mbanë shumë inventarë dhe qarkullimi i saj është i ngadalshëm.²⁸

- **Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme:** Ky raport tregon sesa herë gjatë vitit arkëtohen llogaritë e arkëtueshme. Një qarkullim më i lartë është më i mirë sepse ai tregon efikasitetin e konvertimit të llogarive të arkëtueshme në likuiditete.²⁹
- **Qarkullimi i aktiveve gjithsej:** Ky raport llogaritet si shitjet neto ne raport me aktivet gjithsejtë dhe matë efikasitetin e menaxhimit të të gjitha aktiveve të një shoqërie.³⁰

Treguesit e borxhit: zakonisht këtu përfshihen krahas treguesve tjerë, dy treguesit bazë edhe atë: borxhi total ndaj mjeteve totale dhe borxhi ndaj kapitalit të vet.

“Raporti i borxhit: Analistët financiarë i përdorin raportet e borxhit me qëllim për ta vlerësuar masën e borxhit të firmës dhe aftësinë e saj për të shlyer borxhin. Ka një rëndësi të veçantë dhe kërkohet që gjithmonë të jetë sa më i ulët sepse në rast të falimentimit të firmës të mos ketë rrezik për kreditorët, pra kreditorët janë ato të cilët janë më të interesuar po ashtu edhe aksionarët për raportin e borxhit sepse me rritjen e borxhit rritet edhe risku i tyre. Raporti llogaritet si:

- **Borxhi total ndaj mjeteve totale:** Ky tregues llogaritet si borxhi gjithsej me aktivet totale, ku borxhi gjithsej i përfshijnë detyrimet afatshkurtra dhe detyrimet afatgjata. Raporti i matë fondet totale të siguruara nga kreditorët. Nëpërmjet këtij raporti ne mund të shohim sesa për qind e mjeteve totale të firmës i takojnë borxhit.
- **Borxhi ndaj kapitalit të vet** e shpreh përqindjen e borxhit në kapitalin e vetë. Ai tregon nëse shoqëria ka një shumë të madhe të borxhit në kapitalin e vetë. Firmat të cilat shoqërohen më një nivel të lartë të borxhit kanë risk të lartë në periudhat e vështirësive financiare”.³¹

²⁸ Halit Xhafa, Analiza e pasqyrave financiare, Tiranë, 2005, fq. 224.

²⁹ Po aty, fq. 223

³⁰ Po aty, fq. 225.

³¹ Halit Xhafa, Drejtimi financiar, Tiranë, 2005, fq. 78.

Kreu 3. Metodologjia e hulumtimit

3.1. Përshkrimi i firmës dhe burimet e të dhënave

Në këtë pjesë së pari prezantohen disa të dhëna të përgjithshme dhe të veçanta për rastin studimor të zgjedhur në këtë punim magjistrature. Këto të dhëna janë të domosdoshme për analizë të pasqyrave financiare të dihen nga analisti financiar dhe që sugjerimet, implikimet, diskutimet, rezultatet dhe vendimmarrja të jetë sa më e drejtë dhe e saktë.

Padyshim që një rezultat financiar apo ekonomik i fituar dhe duke mos ditur ambientin si brenda ashtu edhe jashtë biznesit, është i prirë për t'u interpretuar jo drejtë, por mbase edhe e shtrembëron realitetin afarist. Andaj, gjykoj se këto të dhëna bashkë me rezultatet e fituara do të kompletonin mozaikun e përgjithshëm që analiza e treguesve financiare të shërben me të vërtet si një mjet që do të ndihmonte vendimmarrjen afariste.

Firma “Meti Komerc” është e vendosur në fshatin Dobrosht - Tearcë. “Meti Komerc” (organizuar si DOOEL, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar SHPK) është një firmë e cila merret me ndërtimtari dhe shitje të materialeve ndërtimore.

Nevzat Asani i cili është edhe drejtori i firmës e themeloi këtë firmë para 27 vjetëve më 11.07.1993, ai e themeloi këtë firmë nga ideja që kjo firmë do t'i përmbushte nevojat dhe kërkesat e konsumatorëve, si dhe me çmime më të volitshme se konkurrentët që ekzistonin në atë kohë. Numri i të punësuarve të firmës ndër vite ka ndryshuar dhe sillet diku 9-15 të punësuar, ndërsa gjatë periudhave kohore të vitit, punësohen edhe më tepër punëtorë me kontratë të përkohshme.

Nga menaxheri i firmës mësojmë se me rritjen e firmës dhe zgjerimin e punëve duke filluar me blerjen dhe shitjen e materialeve ndërtimore, blerjen e makinave të ndryshme të cilat shfrytëzohen për punë të ndryshme në kuadër të aktivitetit afarist etj. është shënuar rritje e konsiderueshme e numrit të klientëve. Kuptohet, kjo ka ndikuar edhe në të hyrat e firmës në funksion të përmirësimit të performancës financiare.

Çka ofron firma Meti Komerc?

Firma “Meti Komerc” dallohet me kualitetin e shërbimeve që i ofron, krahas konkurrencës që operon në tregun e vendit. Firma në fjalë disponon një menaxhim dhe një staf kreativ të përgjegjshëm dhe të motivuar. Si prioritet i kushton rëndësi themelimin e marrëdhënieve të mira me klientët aktual po ashtu edhe me ato potencial në tregun e

ndërtimtarisë. Edhe pse firma në fillimet e saja ka hasur një konkurrencë shumë të fortë në treg, prapë se prap ka arritur që me punë dhe përkushtim të jetë një firmë e suksesshme në rajonin e Pollogut.

Firma në fjalë vepron tani më një kohë të gjatë në treg dhe ka një staf të kualifikuar si dhe punëtorë në punishte duke realizuar kështu objekte-ndërtime që dallohen për nga stabiliteti si dhe cilësia e lartë. E për këtë cilësi rezultati është nga faktori njeri, nga zbatimi i rregullave, materialeve të përdorura në ndërtim etj. Pikërisht do t'i cekim më në detaje punët e firmës edhe atë:

- **Punët e ndërtimtarisë:**
 - Ndërtimi i shtëpive,
 - Apartamente,
 - Mureve të ndryshëm,
 - Ndërtimin e garazheve etj.



Figura 2: Ndërtime nga firma Meti Komerc

Burimi: webfaqja e firmës “Meti Komerc”: www.Metikomerc.com.

- **Materialet për ndërtim si dhe pajisjet të cilat i ofron firma:**
 - Tulla,
 - Pllaka të kulmit,
 - Tubabetoni,
 - Qymyr,

- Çimento,
- Sharrat,
- Makineri,
- Pajisjet e punës etj.



Figura 3: Materialet për ndërtim si dhe pajisjet

Burimi: Webfaqja e firmës “Meti Komerc”: www.Metikomerc.com.

- **Mjetet transportuese dhe mjetet për shembje dhe gërmime**

Meti Komerc posedon edhe makineri të rëndë të cilat mundësojnë shembjen e çfarëdo lloj objekti, si dhe me kamionët të cilët i posedojnë u sigurojnë një mundësi të madhe të llojeve të transportit për projekte të ndërtimit. Po ashtu firma në fjalë ofron edhe shërbimet e gërmimit me një gamë të gjerë të opsioneve me makineritë e duhura, pra ato mundëson hapjen e vrimave të ndryshme, kanaleve, bodrumeve etj. me çmime të ulëta si dhe me kohë të shpejtë.



Figura 4: Mjetet transportuese dhe mjetet për gërmime

Burimi: Webfaqja e firmës “Meti Komerc”:www.Metikomerc.com.

Struktura menaxheriale dhe organizative e firmës

Përpara se të vazhdojmë me pjesën e analizave dhe interpretimin e rezultateve – treguesve financiarë, në vazhdim jepet struktura menaxheriale e firmës “Meti-Komercë” si në vijim.




Figura 5: Struktura menaxheriale e firmës Meti-Komerc

Burimi: Përpunim nga Autori.

Në firmën “Meti-Komerc” marrja e vendimeve bëhet nga drejtori i cili është Nevzat Asani, i cili kryesisht merret me këto punë:

- Ai organizon dhe udhëheq me procesin e punës,
- Në mënyrë të pavarur është përgjegjës për ligjshmërinë e punës në firmë, i kryen të gjitha detyrat e përcaktuara me ligj,
- E përfaqëson firmën,
- Bën pranimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës për të punësuarit,
- Është përgjegjës për funksionin e kontabilitetit në firmë, përgatit dhe aplikon procedurat e kontabilitetit sipas ligjit etj.

Po ashtu në hierarkinë e firmës “Meti-Komerc” në nivelin e mesëm të menaxhimit është i vendosur menaxheri i firmës i cili realizon këto detyra:

- Bën organizimin dhe ndarjen e punëve në firmë,
- Në mungesë të drejtorit të firmës e përfaqëson firmën,
- Organizon transportin e mallrave,
- Udhëheq dhe menaxhon me financat e firmës,
- Bën pranimin dhe dërgimin e dokumentacionit të firmës,
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit,
- Krijon ambient pune pozitiv në firmë,
- I përcjellë të punësuarit dhe e matë performancën e tyre.

Ndërsa në nivelin e ulët të menaxhimit janë të vendosur të punësuarit e firmës, ku përgjegjësia e tyre është në:

- Realizimin e objekteve ndërtimore,
- Transportimin e mallrave,
- Realizimin e detyrave të tjera të caktuar nga menaxheri dhe drejtori,
- Përgjegjës për shitjen e shërbimeve etj.

3.2 Hipotezat

Hipotezat e ngritura bazohen në qëllimet e këtij studimi. Perceptimi i parë është se ecuria e biznesit ka pësuar ndryshime. Ngjel detyra jonë që përmes analizës së treguesve financiarë të vërtetojmë nëse treguesit janë përmirësuar apo përkeqësuar dhe në ç' masë. Atëherë, hipoteza e parë tregon se gjendja financiare e firmës për periudhën në fjalë është përmirësuar dhe ajo alternative është se është përkeqësuar. Pra:

H_{1_0} – Gjendja financiare e firmës “Meti Komerc” është përmirësuar gjatë periudhës 2012-2016.

H_{1_a} – Gjendja financiare e firmës “Meti Komerc” është përkeqësuar gjatë periudhës 2012-2016.

Hipoteza e dytë bazë tregon se performanca financiare e firmës për periudhën në fjalë është përmirësuar dhe ajo alternative është se është përkeqësuar. Pra:

H_{2_0} – Performanca financiare e firmës “Meti Komerc” është përmirësuar gjatë periudhës 2012-2016.

H_{2_a} – Performanca financiare e firmës “Meti Komerc” është përkeqësuar gjatë periudhës 2012-2016.

Hipoteza e tretë mbështetet në dy hipotezat paraprake dhe gjithashtu është produkt i tyre për të parë sesa dhe si është shfrytëzuar analiza e treguesve financiarë në vendimmarrjen menaxheriale. Pra:

H_{3_0} – Ekipi menaxhues “Meti Komerc” ka përdorur analizën e treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste gjatë periudhës 2012-2016 në funksion të përmirësimit të tyre.

H_{3_a} – Ekipi menaxhues “Meti Komerc” nuk ka përdorur analizën e treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste gjatë periudhës 2012-2016 në funksion të përmirësimit të tyre.

Verifikimi, pranimi apo mospranimit i hipotezave do të bëhet përmes testimit të tyre, si nga analiza e treguesve financiarë në kuptim të dhënave kontabël dhe financiar, por edhe përmes intervistimit të menaxherëve dhe të punësuarve si formë e tërthortë (përmes pyetësorit). Kështu që do të konstatojmë nëse vendimmarrja menaxheriale ka qenë në bazë të intuitës dhe përvojës menaxheriale, apo sipas treguesve financiar.

3.3 Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia e hulumtimit të punimit ka të bëjë me identifikimin e objektivave në bazë të të cilave do të kemi një pasqyrë që do të japim baza për aplikime konkrete, mjeteve, teknikave dhe metodave të përdorura.

Struktura e procesit (hapat e metodologjisë së hulumtimit) do të përfshijë kryesisht dhe do të thotë që:

1. Të njohim gjendjen ekonomike-financiare në të cilën gjendet dhe kalon firma (kryesisht faktorët që influencojnë të njëjtat),
2. Të bëjmë identifikimin e nevojave për analizën e treguesve financiarë,
3. Të zgjedhim dhe vlerësojmë të dhënat financiare për analizë,
4. Vëzhgimin dhe analizën e të dhënave financiare dhe jofinanciare për firmën “Meti Komerc”, Dobrosht-Tetovë për periudhën 2012-2016,
5. Të llogarisim dhe të interpretojmë raportet-treguesit financiarë në funksion të vendimmarrjes menaxheriale-biznesore edhe atë në kontekst të rastit studimor etj.

Burimet e të dhënave mbështeten në literaturën e gjërë financiare, pikërisht atë të analizës së pasqyrave financiare, publikimeve të ndryshme nga fusha përkatëse financiare si revista dhe artikuj shkencor, raportet vjetore të firmës “Meti Komerc” Dobrosht për periudhën 2012-2016, buxhetet dhe planet për zhvillime strategjike të firmës “Meti-Komerc” Dobrosht për periudhën 2012-2016 etj.

Të dhënat e zgjedhur nga firma “Meti-Komerc” për periudhën 2012-2016 janë të dhënat bazë në këtë punim (të nxjerra nga bilancet) dhe si të tilla ato në dijeninë tonë nuk janë përpunuar dhe analizuar në kontekst dhe problematikës që ne paraqesim në këtë studim. Përpunimi i të dhënave në aspekt teknik do të bëhet kryesisht përmes Excel-it.

Metodologjia e hulumtimit përfshijnë një proces të tillë që fillon nga e përgjithshmja tek ajo konkrete. Në fund, analizat, komentet, përfundimet dhe rekomandimet ngelin në kontekst të firmës dhe periudhës së zgjedhur. Kështu që ato nuk mund të përgjithësohen për firmat tjera meqenëse çdo biznes është unik në kontekst të periudhës dhe ambientit, qoftë të brendshëm apo të jashtëm ekonomik, financiar, ligjor etj.

Nga bilancet e firmës së përzgjedhur, për efekt të analizave kryesisht do të fokusohemi në analizën e bilancit të gjendjes dhe bilancit të suksesit.

Kreu 4. Analiza dhe diskutimi i rezultateve

4.1 Qëllimet e analizës së treguesve financiarë – rasti studimor

Analiza e treguesve financiarë në kuadër të problemit – rastit studimor ka për qëllim që të detekton problemet, anët e forta dhe të dobëta të biznesit, por njëkohësisht në funksion të nxjerrjes së rekomandimeve apo sugjerimeve të mundshme sesi të njëjtat mund të përmirësohen. Andaj, fillimisht jepen të dhënat apo zërat bilancor nga bilanci i gjendjes sipas krahasimit për çdo vite dhe atë nga 2012 deri në vitin 2016 si në vijim.

Tabela 1: Bilanci i gjendjes 2012-2016

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Patundshmëritë	472,903.00	460,458.00	448,013.00	435,568.00	423,123.00
Mjete materiale	2,919,632.00	2,308,168.00	2,004,180.00	1,813,430.00	1,580,561.00
Gjithsej aktive afatgjata	3,392,535.00	2,768,626.00	2,452,193.00	2,248,998.00	2,003,684.00
Lëndë e parë	5,060,887.00	6,687,659.00	6,577,007.00	8,839,855.00	9,671,245.00
Kërkesa Afatshkurtra	5,186.00	0.00	1,293,549.00	873,299.00	3,388,542.00
Mjete në para dhe ekuivalentët e saj	18,337.00	17,950.00	686,036.00	28,567.00	195,220.00
Gjithsej aktive Afatshkurtra	5,084,410.00	6,705,609.00	8,556,592.00	9,741,721.00	13,255,007.00
Gjithsej aktiva	8,476,945.00	9,474,235.00	11,008,785.00	11,990,719.00	15,258,691.00
Kapitali kryesor	1,788,714.00	2,828,714.00	2,828,714.00	2,828,714.00	2,828,714.00
Fitimi i akumuluar	3,360,721.00	3,676,974.00	4,431,594.00	5,003,059.00	5,603,453.00
Fitimi gjatë vitit	316,253.00	754,620.00	571,465.00	600,394.00	800,959.00
Gjithsej kapitali dhe rezervat	5,465,688.00	7,260,308.00	7,831,773.00	8,432,167.00	9,233,126.00
Detyrime	3,011,257.00	2,213,927.00	3,177,012.00	3,558,552.00	6,025,565.00
Detyrime ndaj furnitorëve dhe detyrime tjera	1,752,038.00	1,597,927.00	2,340,708.00	1,768,066.00	2,452,574.00
Kreditë afatshkurtra	1,116,000.00	616,000.00	616,000.00	1,591,253.00	2,261,000.00
Detyrime tjera	143,219.00	0.00	220,304.00	199,233.00	1,311,991.00
Gjithsej detyrime afatshkurtra	3,011,257.00	2,213,927.00	3,177,012.00	3,558,552.00	6,025,565.00
Gjithsej pasiva	8,476,945.00	9,474,235.00	11,008,785.00	11,990,719.00	15,258,691.00

Duke shfrytëzuar të dhënat e bilancit të gjendjes realizohet analiza strukturore për të krijuar një kuptim më përmbajtësor për strukturën e aktiveve dhe pasiveve të firmës. Më tej, realizohet analiza e trendit.

Tabela 2: Analiza strukturore e bilancit të gjendjes

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Patundshmëritë	5.6 %	4.9%	4.07%	3.6%	2.77%
Mjete materiale	34.4%	24%	18%	15%	10.4%
Gjithsej aktivet afatgjata	40%	30%	22%	19%	13%
Lëndë e parë	59.8%	70%	60%	74%	63%
Kërkesa afatshkurtra	0.061%	0	12%	7.3%	22%
Mjete në para dhe ekuivalentët e saj	0.21%	0.19%	6.2%	0.24%	1.28%
Gjithsej aktivet afatshkurtra	60%	70%	78%	79%	87%
Gjithsej aktiva	100%	100%	100%	100%	100%
Kapitali					
Kapitali kryesor	21.10%	30%	26%	23.5%	18.53%
Fitimi i akumuluar	39.64%	39%	40%	42%	36.72%
Fitimi gjatë një viti	3.73%	8%	5%	5%	5.24%
Gjithsej kapitali dhe rezervat	64.5%	77%	71%	70%	60.5%
Detyrime	35.5%	23%	29%	30%	39.5%
Gjithsej detyrime	35.5%	23%	29%	30%	39.5%
Detyrime afatshkurtra					
Detyrime ndaj furnitorëve dhe detyrime tjera	21 %	17%	21%	15%	16%
Kreditë afatshkurtra	13 %	6.5%	5.5%	13%	15%
Detyrime tjera	2 %	0	2%	2%	9%
Gjithsej detyrime afatshkurtra	35.5%	23%	29%	30%	39.5%
Gjithsej pasiva	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 3: Trendi i zërave sipas analizës strukturore të bilancit të gjendjes 2012-2016

Viti	2012	%	2016	%
Aktivët afatgjata	3,392,535.00	40%	2,003,684.00	13%
Aktivët afatshkurtra	5,084,410.00	60%	13,255,007.00	87%
Gjithsej detyrimet	3,011,257.00	35%	6,025,565.00	39%
Kapitali dhe rezervat	5,465,688.00	64%	9,233,126.00	61%




Figura 6: Trendi i zërave sipas analizës strukturore të aktiveve 2012-2016




Figura 7: Trendi i zërave sipas analizës strukturore të pasiveve 2012-2016

Nga tabela e analizës strukturore të bilancit të gjendjes ne mund të konstatojmë se firma në vitin 2012 ka pasur rrënje të aktiveve afatgjata në krahasim me të gjitha vitet e tjera në vijim nga viti 2013 e deri në vitin 2016. Aktivët afatgjata në vitin 2012 i përbëjnë 40% të aktiveve të përgjithshme, ndërsa në vitet në vazhdim shohim se aktivët afatgjata janë në rrënje edhe atë 30-22-19%. Po ashtu edhe në vitin 2016 ku 13% të aktiveve të përgjithshme i takojnë aktiveve afatgjata.

Arsyeja se pse kemi rrënje të aktiveve afatgjata është pikërisht shkak i zvogëlimit të mjeteve materiale të cilat e përbëjnë pjesën më të madhe të aktiveve afatgjata një nga arsyt kryesore është vjetërsimi i mjeteve të punës të cilat me kalimin e kohës janë zhvlerësuar (amortizuar). Ndërsa e kundërt ka ndodhur me aktivët afatshkurtra ku e shohim se ato i kemi në rritje edhe atë nga 60-70-78-79% e në vitin e fundit aktivët afatshkurtra përbëjnë 87% të aktiveve

të përgjithshme. Arsyeja e rritjes së aktiveve afatshkurtra është si rezultat i rritjes së mallrave(inventarëve) po ashtu edhe rritja e kërkesave ndaj blerësve.

Në pasivën e bilancit e cila përbëhet nga kapitali dhe rezervat dhe detyrimet afatshkurtra mund të shohim se pjesën më të madhe të pasivës nga viti 2012-2016 e përbëjnë kapitali dhe rezervat e firmës ndërsa pjesën më të vogël të pasivës e përbëjnë detyrimet. Viti me nivel më të lartë të kapitalit dhe rezervave ka qenë viti 2013 me 77% e pasivës, ndërsa detyrimet kanë qenë 23%, si dhe në viti 2014 ku kapitali dhe rezervat përbëjnë 71% të pasivës dhe detyrimet 29%.

Tabela 4: Analiza vit pas viti e bilancit të gjendjes 2012-2016

Vitet	2012/11	2013/12	2014/13	2015/14	2016/15
Patundshmëritë	8%	-2.6%	-2.7%	-2.7%	-2.8%
Mjete materiale	-9.5%	-20.9%	-13%	-9.5%	-13%
Gjithsej Aktive Afatgjata	8%	-18.3%	-11%	-8.2%	-11%
Lëndë e parë	-16%	32.14%	-1.6	34.4%	9.5%
Kërkesa afatshkurtra	-99%	-100	0.00	-32.4%	288%
Mjete në para dhe ekuivalentët e saj	-89%	-2%	37%	-95%	583%
Gjithsej aktive afatshkurtra	-23%	32%	28%	14%	36%
Gjithsej aktiva	-13%	12%	16%	9%	27%
Kapitali					
Kapitali kryesor	0.00	58%	0.00	0.00	0.00
Fitimi i akumuluar	14%	9.4%	21%	13%	12%
Fitimi gjatë një vitit	-21%	138%	-24%	5%	33.4%
Gjithsej kapitali dhe rezervat	6%	33%	8%	8%	10%
Detyrime tjera	0.00	-26%	44%	12%	69%
Gjithsej detyrime	-35%	-26%	44%	12%	69%
Detyrime ndaj furnitorëve dhe detyrime tjera	-27%	-9%	46%	-24%	39%
Kreditë afatshkurtra	81%	-45%	0.00	158%	42%
Detyrime tjera	-45%	-100%	0.00	-10%	558%
Gjithsej detyrime afatshkurtra	-8%	-26%	44%	12%	69%
Gjithsej pasiva	-13%	12%	16%	9%	27%

Tabela 5: Trendi i zërave të bilancit të gjendjes 2012-2016

Viti	2012	%	2016	%
Aktivët afatgjata	3,392,535.00	8 %	2,003,684.00	-11%
Aktivët afatshkurtra	5,084,410.00	-23%	13,255,007.00	36%
Gjithsej detyrimet	3,011,257.00	-35%	6,025,565.00	69%
Kapitali dhe rezervat	5,465,688.00	6%	9,233,126.00	10%




Figura 8: Trendi i aktiveve 2012-2016




Figura 9: Trendi i pasiveve 2012-2016

Nëse analizojmë aktivën e bilancit mund të shohim se firma ka një rritje të aktiveve afatshkurtra dhe e kundërta ka ndodhur me aktivet afatgjata. Pra, pjesëmarrje më të madhe kanë aktivet afatshkurtra, prej të cilave një pjesë e vogël përbëhet prej mjeteve në para dhe ekuivalentët e saj si dhe aktivet likuide prej të cilave do mund të shlyhen detyrimet afatshkurtra.

Arsyeja e rrënjës së aktiveve afatgjata është si rezultat i rrënjës së mjeteve materiale, ndërsa arsyeja e rritjes së aktiveve afatshkurtra vjen si rezultat i rritjes së kërkesave të firmës. Ndërsa arsyeja e rritjes së detyrimeve vinë si pasojë e mos arkëtimit të kërkesave të firmës.

Nga analiza dinamike e bilancit të gjendjes mund të shohim se detyrimet afatshkurtra të firmës të vitit 2012 me vitin 2013 janë zvogëluar për 26%, në vitin 2013 në krahasim me vitin 2014 detyrimet afatshkurtra të firmës janë rritur për 44%, edhe në vitet në vazhdim pra në vitin 2016 ka një nivel të lartë të detyrimeve, gjegjësisht kur firma financohet 69% me borxh.

Kjo strukturë e firmës nuk është një gjendje përgjithësisht e mirë, pra firma nuk ka një strukturë të qëndrueshme dhe se likuiditeti ka rënë në mënyrë drastike. Ndërsa nëse vërejmë kapitalin e firmës në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012 është në rritje për 33%, në vitet në vazhdim 2014/2013 kemi rritje për 8% si dhe vitet e fundit 2015/2014 dhe 2016/2015 kemi rritje të kapitalit dhe rezervave për 8% dhe 10%.

Tabela 6: Bilanci i suksesit 2012-2016

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Të hyra nga shitja	15,799,199.00	15,932,944.00	20,891,326.00	22,465,936.00	21,715,984.00
Të hyra tjera operative	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej të hyra operative	15,799,199.00	15,932,944.00	20,891,326.00	22,465,936.00	21,715,984.00
Shpenzime për lëndët e para dhe materialet tjera	918,826.00	1,249,431.00	1,604,201.00	984,804.00	672,008.00
KMSH	12,666,174.00	11,511,967.00	16,176,057.00	18,518,280.00	17,560,947.00
Shpenzimet e materialeve	239,493.00	0.00	0.00	125,581.00	289,212.00
Shpenzime për punëtorët	1,658,453.00	1,786,363.00	1,803,204.00	1,520,617.00	1,370,728.00
Amortizimi i aktiveve	0.00	630,563.00	563,252.00	581,712.00	843,673.00
Shpenzime tjera operative	0.00	0.00	109,651.00	67,838.00	89,462.00
Gjithsej Shpenzime	15,482,946.00	15,178,324.00	20,146,714.00	21,730,994.00	20,736,568.00
Fitimi (humbja) para tatimit	316,253.00	754,620.00	634,961.00	667,104.00	889,954.00
Tatimi në fitim	0.00	0.00	63,496.00	66,710.00	88,995.00
Neto fitimi (humbja)	316,253.00	754,620.00	571,465.00	600,394.00	800,959.00

Tabela 7: Analiza strukturore e bilancit të suksesit 2012-2016

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Të hyra nga shitja	100%	100%	100%	100%	100%
Të hyra tjera operative	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Total të hyra operative	100%	100%	100%	100%	100%
Shpenzime për lëndët e para dhe materiale tjera	6%	8%	7%	4%	3%
KMSH	80%	72%	77%	82%	81%
Shpenzimet e materialeve	1.5%	0.00	0.00	7%	2%
Shpenzime për punëtorët	10 %	11%	9%	7%	6%
Amortizimi i aktiveve	0.00	4%	3%	3%	4%
Shpenzime tjera operative	0.00	0.00	0.525%	0.30%	0.41%
Gjithsej Shpenzime	98%	95%	96.44%	96.72%	95.4898%
Fitimi (humbja) para tatimit	2%	5%	3%	3%	4.0981%
Tatimi në fitim	0.00	0.00	0.3%	0.2%	0.4%
Neto fitimi (humbja)	2%	5%	3%	3%	3.688%

Tabela 8: Trendi i zërave sipas analizës strukturore të bilancit të suksesit 2012-2016

Viti	2012	%	2016	%
Gjithsej të hyrat	15,799,199.00	100%	21,715,984.00	100%
Gjithsej shpenzimet	15,482,946.00	98%	20,736,568.00	95.4898%
Fitimi neto	316,253.00	2%	800,959.00	3.688%




Figura 10: Trendi i zërave sipas analizës strukturore të fitimit neto, shpenzimeve dhe të ardhurave 2012-2016

Në bazë të analizës strukturore të bilancit të suksesit shihet se bilanci i suksesit kryesisht përbëhet prej të hyrave të cilat i realizon firma si dhe prej shpenzimeve të cilat i bën firma për të realizuar aktivitetin e saj.

Andaj në bilancin e suksesit dhe shpenzimeve mund të vërejmë luhatjen e fitimi neto nga 2% në 5% në vitin 2013 dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së të hyrave nga shitja si dhe rënies së shpenzimeve në 95% nga 98%. Megjithatë, në vitin 2014 fitimi neto shënon rritje vetëm për 3% për shkak të rritjes së shpenzimeve operative në 96%. Në fund të vitit 2016 firma ka shënuar një rritje të fitimit neto për 4% si dhe shpenzimet kanë rënë në 95%.

Tabela 9: Analiza viti pas viti e bilancit të suksesit 2012-2016

Vitet	2012/11	2013/12	2014/13	2015/14	2015/16
Të hyra nga shitja	-2.4%	0.84%	31%	8%	-3.3%
Të hyra tjera operative	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej të hyra operative	-2.4%	0.84%	31%	8%	-3.3%
Shpenzime për lëndët e para dhe materiale tjera	97%	36%	28%	-39%	-32%
KMSH	-6.8%	-9%	41%	14%	-5%
Shpenzimet e materialeve	18%	-100%	0	0	130%
Shpenzimet për punëtorët	9%	8%	0.94%	-16%	-10%
Amortizimi i aktiveve	0.00	0.00	-11%	3.2%	45%
Shpenzime tjera operative	0.00	0.00	0.00	-22%	32%
Gjithsej Shpenzimet	-1.9%	-2%	33%	8%	-5%
Fitimi (humbja) operative	-21%	138%	-16%	5%	33%
Fitimi (humbja) para tatimit	-21%	138%	-16%	5%	33%
Tatimi në fitim	0	0	0	5%	33%
Neto fitimi (humbja)	-21%	138%	-24%	5%	33%

Tabela 10: Trendi i zërave sipas analizës dinamike të bilancit të suksesit 2012-2016

Viti	2012	%	2016	%
Gjithsej të hyrat	15,799,199.00	-2.4%	21,715,984.00	-3.3%
Gjithsej shpenzimet	15,482,946.00	-1.9%	20,736,568.00	-5%
Fitimi neto	316,253.00	-21%	800,959.00	33%




Figura 11: Trendi i fitimit neto, shpenzimeve dhe të ardhurave 2012-2016

Analiza tregon se zërat në pasqyrën e të hyrave kanë lëvizur si vijon:

Gjatë periudhës 2012–2013 nëse i analizojmë të hyrat mund të vërejmë se firma gjeneron të hyra të larta të cilat kryesisht vijnë nga shitja e pjesëve ndërtimore të cilat i posedon firma. Kjo mund të shihet në bilancin e gjendjes tek aktivet afatgjata të cilat janë në vlerë 3,392,535.00 denarë në vitin 2012, ndërsa pas shitjes aktivet afatgjate janë në vlerë 2,768,626.00 denarë në vitin 2013.

Pas kësaj në vitet në vazhdim 2014-2015 e deri në vitin 2016 gjithmonë kanë pasur ulje të cilat arrijnë vlerën 2,003,684.00 denarë. Viti më i suksesshëm ku firma ka gjeneruar të hyra më të larta është viti 2016 me 21,715,984 denarë, ndërsa gjatë vitit 2012-2013 gjithsej shpenzimet kanë rënë për 2%, edhe fitimi neto pësoi një rritje prej 138%.

Nëse krahasojmë periudhën 2014-2013 gjithsej shpenzimet janë rritur për 33%, si dhe fitimi neto ka rënë në 24%. Si dhe krahasimi i vitit 2015–2014 tregon se gjithsej shpenzimet kanë rënë në 5% si dhe fitimi neto është rritur për 5%, si dhe krahasimi i vitit 2016/2015 gjithsej shpenzimet janë zvogëluar për 5%, ndërsa fitimi neto është rritur për 33%.

Po ashtu nëse vërejmë rritja e shpenzimeve fikse ndodhën edhe për shkak të amortizimit ku mund të shohim se është në rritje edhe atë në vitin 2016 është 45%, firma duhet që të blejë makineri të reja sepse ato kanë normë më të ulët të amortizimit. Mjetet e vjetra janë shoqëruar me normë më të lartë të amortizimit.

Më tej, tek bilanci i suksesit mund të tregohet se kemi rritje të të hyrave dhe fitimit neto nga viti në vit, por edhe shpenzimet nga viti në vit janë në rritje, e veçanërisht zërat të cilat më shumë kanë ndryshuar janë shpenzimet për lëndë të para dhe materialeve. Kjo do të thotë se kanë lëvizur shumat në anën pozitive dhe në anën negative, mirëpo duhet të cekim se kemi edhe rritjen e shpenzimeve të cilat janë të lidhura me shpenzime të të punësuarve duke pasur parasysh se paguhen me rrogë fikse, rritja e shpenzimeve të materialeve të firmës, shpenzime për punëtorët, shpenzimet e amortizimit, zgjerimi i gamës së shërbimeve të ofruara si dhe shpenzimeve tjera operative dhe këto shpenzime bëhen për shkak të realizimit të aktiviteteve të firmës.

Në vazhdim, meqenëse u paraqit analiza strukturore për dy bilancet kryesore që firma në fjalë përgatit, është me e lehtë që të bëhet llogaritja dhe sidomos më tej interpretimi i treguesve financiarë, qoftë nga perspektiva tradicionale ose funksionale.

Raportet e likuiditetit:

Raporti vijues: $\text{Raporti vijues} = \text{Aktivet afatshkurtra} / \text{Detyrimet afatshkurtra}$

Tabela 11: Raporti vijues 2012-2016

Viti	Aktivet afatshkurtra	Detyrimet afatshkurtra	Raporti vijues
2012	5,084,410	3,011,257	1.69 herë
2013	6,705,609	2, 213,927	3.02 herë
2014	8,556,592	3, 177, 012	2.69 herë
2015	9,741,721	3,558,552	2.73 herë
2016	13,255,007	6,025,565	2.19 herë




Figura 12: Treguesit e likuiditetit-Raporti i aktiveve afatshkurtra me detyrimet afatshkurtra

Raporti vijues paraqet aftësinë e firmës për t'i përmbushur kërkesat e kreditorëve. Në bazë të rezultateve ne mund të shohim se në vitin 2012 aktivet afatshkurtra mbulonin detyrimet afatshkurtra për 1.69 herë, pastaj e vërejmë se në vitin 2013 kemi rritje të koeficientit edhe atë në 3.02 herë. Shkak për rritjen e koeficientit është rritja e aktiveve afatshkurtra.

Në vitin 2014 ka pasur një koeficient 2.69 pastaj në vitin 2015 firma “Meti-Komerc” me aktivet afatshkurtra i mbulon detyrimet për 2.73 herë, pra pak më shumë se nga viti 2014 ndërsa në vitin e fundit kemi një koeficient prej 2.19. Nga kjo analizë mund të themi se kapitali punues i firmës ka vlera pozitive.

Norma e kesh-it: Norma e kesh-it = Ekuivalentët e kesh-it / aktivet afatshkurtra

Tabela 12: Norma e kesh-it

Viti	Ekuivalentët e kesh-it	Aktivët afatshkurtra	Norma e kesh-it
2012	18,337	5,084,410	0.0036
2013	17,950	6,705,609	0.0027
2014	686,036	8,556,592	0.0801
2015	28,567	9,741,721	0.0029
2016	195,220	13,255,007	0.0147




Figura 13: Treguesit e likuiditetit - Raporti ekuivalentët e kesh-it me aktivët afatshkurtra

Sipas analizës së normës së kesh-it mund të konstatojmë se firma në vitin 2013 ka një rrënjë të këtij koeficienti, ku më pas kemi një rritje në vitin 2014 pastaj ka vazhduar me rrënjë si dhe në fund të viti 2016 e shohim se kemi tendencë rritëse. Mirëpo gjatë viteve të cilat kompania është shoqëruar me rënie të këtij koeficienti ajo nuk mund të mbështetet në parat e saj nga aktivitetet operative për t'i mbuluar detyrimet e saj aktuale.

Likuiditeti vijues (Testi acid)

Testi acid = keshi + ekuivalentët e kesh-it + fondet e tregtueshme + llogaritë e arkëtueshme / Detyrime korrente

Tabela 13: Testi acid

Viti	Kesh+ekuivalentët e kesh-it+fondet e tregtueshme+llogaritë e arkëtueshme	Detyrimet afatshkurtra	Testi acid
2012	18,337 + 5,186	3,011,257	0.0078
2013	17,950 + 0	2,213,927	0.0081
2014	686,036 + 1,293,549	3,177,012	0.6230
2015	28,567 + 873,299	3,558,552	0.2534
2016	195,220 + 3,388,542	6,025,565	0.5947




Figura 14: Treguesit e likuiditetit - Testi acid

Në bazë të analizës ne mund të shohim se aftësia e firmës për t'i kthyer asetet-mjetet e saja në mjete likuide dhe për t'i paguar detyrimet e saj është e vështirë, ngase në të gjitha vitet ky raport është nën 1.

Pra, firma nuk do jetë në gjendje t'i paguaj detyrimet e saja. Sipas testit acid tregohet se aktivet afatshkurtra siç janë mjetet në para dhe llogaritë e arkëtueshme mbulojnë detyrimet vijuese në vitin 2012 me 0.0078 herë.

Po ashtu ky raport edhe në vitet e vazhdim është i ulët dhe tregon se inventarët janë të mëdha të cilët e pengojnë-blokojnë likuiditetin e firmës. Pra, duke parë rezultatet e fituara firma

ka investuar shumë në inventarë, duke rritur njëkohësisht edhe shpenzimet siç e pamë edhe tek bilanci.

Treguesit e rentabilitetit

Fitimi marginal bruto

$$\text{FMB} = \text{Fitimi bruto} / \text{Shitjet neto}$$

Tabela 14: Raporti bruto fitim me shitjet neto

Viti	Fitimi bruto	Shitjet neto	Fitimi marginal bruto	%
2012	316,253	15,799,199	0.020	2
2013	754,620	15,932,944	0.047	4.7
2014	634,961	20,891,326	0.030	3
2015	667,104	22,465,936	0.029	2.9
2016	889,954	21,715,984	0.040	4




Figura 15: Treguesit e rentabilitetit- Raporti bruto fitim me shitjet neto

Në treguesit e rentabilitetit tek raporti bruto fitim me shitjet neto vërejmë se nga rezultatet e fituara në vitet 2012, 2014 dhe 2015 është i ulët pra 2%, 3% dhe 2.9%, si dhe në vitin e fundit e shohim se ka filluar të rritet dhe ka arritur 4% që tregon një përmirësim të vogël. Mirëpo duke vlerësuar mesataren e industrisë 17.4% ne mund të themi se ajo nuk ka një normë të lartë për t'i siguruar firmës një pozicion të mirë financiar.

Fitimi marginal neto

$$\text{FMN} = \text{Fitimi neto} / \text{Shitjet neto}$$

Tabela 15: Raporti fitimi neto me shitjet neto

Viti	Fitimi neto	Shitjet neto	Fitimi marginal neto	%
2012	316,253	15,799,199	0.020	2
2013	754,620	15,932,944	0.047	4.7
2014	571,465	20,891,326	0.027	2.7
2015	600,394	22,465,936	0.026	2.6
2016	800,959	21,715,984	0.036	3.6




Figura 16: Treguesit e rentabilitetit- Raporti fitimi neto me shitjet neto

Raporti i fitimit neto e matë përfitueshmërin e veprimtarive operative pasi i merr parasysh të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat. Në vitin 2012 tregohet se ky koeficient është 2%, në vitin 2013 kemi një rritje edhe atë për 4.7% pastaj gjatë viteve kemi një luhatje dhe në fund të vitit 2016 ky koeficient është 3.6%. Për firmën është e dobishme që ky raport të jetë sa më i lartë, ky raport përmirësohet me rritjen e të ardhurave nga shitja duke i mbajtur shpenzimet në një nivel më të ulët.

Norma e kthimit të aktiveve (ROA)

$$\text{ROA} = \text{Fitimi neto} / \text{Aktive gjithsej}$$

Tabela 16: Norma e kthimit të aktiveve (ROA)

Viti	Fitimi neto	Aktivet gjithsej	ROA	%
2012	316,253	8,476,945	0.0373	3.73
2013	754,620	9,474,235	0.0796	7.96
2014	571,465	11,008,785	0.0519	5.19
2015	600,394	11,990,719	0.0500	5
2016	800,959	15,258,691	0.0524	5.24




Figura 17: Norma e kthimit të aktiveve

Siç mund të shohim norma e kthimit të aktiveve në fillim të vitit 2012 ka qenë 3.73%, pastaj në vitet në vazhdim 2013-2014-2015 kemi një rritje të këtij koeficienti-treguesi edhe atë 7.96, 5.19%, 5% edhe në vitin 2016 kemi një koeficient 5.24. Pra, kemi një gjendje të mirë vit pas viti, ky rezultat është arritur si rezultat në përdorimin me efektivitet të aktiveve për gjenerimin e fitimit dhe mund të themi se për firmën ky trend rritës është i zakonshëm dhe i pritshëm.

Norma e kthimit të kapitalit fitimi neto / kapitali i pronarit

$$\text{ROE} = \text{Fitimi neto} / \text{Kapitali}$$

Tabela 17: Norma e kthimit të kapitalit (ROE)

Viti	Fitimi Neto	Kapitali	ROE	%
2012	316,253	5,465,688	0.0578	5.78
2013	754,620	7,260,308	0.1039	10.39
2014	571,465	7,831,773	0.0729	7.29
2015	600,394	8,432,167	0.0712	7.12
2016	800,959	9,233,126	0.0867	8.67




Figura 18: Norma e kthimit të kapitalit

Kthimi nga kapitali kryesor (ROE) llogaritet si e ardhura neto në raport me kapitalin themelor. Nga analiza e bërë e shohim se ky tregues lëvizë në intervalin 6% – 10% dhe kemi një rritje të konsiderueshme. Ndërsa sipas koeficienteve të fituar mund të vërejmë që kthimi nga aktivet (ROA) lëviz në intervalin 4% – 8% dhe kjo diferencë në mes dy treguesve bazë i referohet përdorimit të detyrimeve. Megjithatë, firma ka regjistruar një përmirësim sipas periudhës së analizës.

Qarkullimi i inventarit

$$\text{Qarkullimi i inventarit} = \text{Shitjet} / \text{Inventari}$$

Tabela 18: Qarkullimi i inventarit

Viti	Shitjet	Inventari	Qarkullimi i inventarit
2012	15,799,199	5,060,887	3.12
2013	15,932,944	6,687,659	2.4
2014	20,891,326	6,577,007	3.1
2015	22,465,936	8,839,855	2.5
2016	21,715,984	9,671,245	2.2




Figura 19: Qarkullimi i inventarit

Qarkullimi i inventarit tregon likuiditetin e inventarit. Qarkullimi i inventarit në fillim të vitit 2012 është 3.1 ndërsa në vitin 2016 është 2.2. Pra, mund të themi sesa më i lartë të jetë ky koeficient aq më efikas do të jetë menaxhimi i inventarëve. Mirëpo, në rastin studimor firma ka një koeficient përgjithësisht të pranueshëm duke marrë në konsideratë edhe aktivitetin afarist që realizon.

Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme

Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme = Shitjet / Llogaritë e arkëtueshme

Tabela 19: Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme

Viti	Shitjet	Llogaritë e arkëtueshme	Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme	Periudha mesatare e arkëtimit
2012	15,799,199	5,186	3,046 herë	0.12 ditë
2013	15,932,944	0	0	/
2014	20,891,326	1,293,549	16.15 herë	22 ditë
2015	22,465,936	873,299	25.72 herë	14 ditë
2016	21,715,984	3,388,542	6.40 herë	56 ditë



Figura 20: Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme

Firma “Meti-Komerc” në vitin 2012 ka kthyer llogaritë e arkëtueshme në likuiditete 3,046 herë brenda vitit dhe kjo bënë edhe rezultatin e periudhës mesatare të arkëtimit jo të zakonshëm, pra 0.12 ditë. Pastaj në vitin 2014 e shohim që ky koeficient është rritur dhe është 16 herë, kurse në vitin 2015 është 25 herë. Pra, deri këtu mund të themi se firma e ka përmirësuar qarkullimin e arkëtimit pasi firma gjatë këtyre viteve i ka arkëtuar kërkesat në më pak se një muaj, mirëpo pastaj në vitin 2016 qarkullimi i llogarive të arkëtueshme është vetëm 6 herë pra përfaqëson firmën që ka arkëtuar kërkesat brenda 2 muajve. Në përgjithësi mund të themi se qarkullimi më i lartë është më i mirë, sepse ai na tregon efikasitetin e konvertimit të llogarive të arkëtueshme në likuiditete.

Qarkullimi i aktiveve gjithsej

$$\text{Qarkullimi i aktiveve gjithsej} = \text{Shitjet} / \text{Aktivet gjithsej}$$

Tabela 20: Qarkullimi aktiveve gjithsej

Viti	Shitjet	Aktivet gjithsej	Qarkullimi i aktiveve gjithsej
2012	15,799,199	8,476,945	1.9
2013	15,932,944	9,474,235	1.7
2014	20,891,326	11,008,785	1.9
2015	22,465,936	11,990,719	1.9
2016	21,715,984	15,258,691	1.4




Figura 21: Qarkullimi i aktiveve gjithsej

Raporti i qarkullimit të aktiveve gjithsej e matë efikasitetin e firmës gjatë shfrytëzimit të mjeteve të saja për gjenerimin e të hyrave. Sa më i lartë të jetë ky raport aq më mirë është për firmën përgjithësisht. Mirëpo nga tabela e qarkullimit të aktiveve e shohim se ky raport ka qenë në intervalin 1.4 herë – 1.9 herë dhe mund të themi se raportet e qarkullimit të mjeteve janë përgjithësisht të mira. Arsyeja është se investimi në aktive është i lartë, mirëpo rritja e qarkullimit të aktiveve është rezultat i përmirësimit edhe të inventarit dhe qarkullimit të llogarive të arkëtueshme.

Raporti i borxhit

Raporti i borxhit = Borxhi gjithsej / Aktivët gjithsej

Tabela 21: Raporti i borxhit gjithsej me aktivët gjithsej

Viti	Borxhi gjithsej	Aktivët gjithsej	Raporti i borxhit	%
2012	3,011,257	8,476,945	0.35	35
2013	2,213,927	9,474,235	0.23	23
2014	3,177,012	11,008,785	0.28	28
2015	3,558,552	11,990,719	0.30	30
2016	6,025,565	15,258,691	0.39	39



Figura 22: Raporti i borxhit gjithsej me aktivët gjithsej

Në bazë të treguesve të borxhit ne mund të themi se 35% e aktiveve gjithsej të firmës në vitin 2012 i takojnë borxhit, pastaj në vitin 2013 e shohim se ky koeficient është në rënie edhe atë 23%, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 28%, po ashtu në vitin 2015 kemi një koeficient prej 29%, ndërsa në vitin 2016 ky raport është 39% pra, në vitin e fundit mund të themi se sipas raportit të borxhit vërejmë që ka një trend rritës të rritjes së borxhit, mirëpo duke e pasur parasysh industrinë në të cilën operon firma nuk është shumë i lartë.

Raporti i Borxhit

Raporti i Borxhit = Detyrime gjithsej / Kapitali aksionar

Tabela 22: Raporti i borxhit me kapitalin gjithsej

Viti	Detyrimet	Kapitali	Raporti i borxhit	%
2012	3,011,257	5,465,688	0.55	55
2013	2,213,927	7,260,308	0.30	30.5
2014	3,177,012	7,831,773	0.40	40.6
2015	3,558,552	8,432,167	0.42	42
2016	6,025,565	9,233,126	0.65	65




Figura 23: Raporti i borxhit me kapitalin gjithsej

Sipas raportit të borxhit me kapitalin gjithsej, tregohet se burimi i financimit të firmës me borxh në vitin 2012 është 55%, pastaj në vitet në vazhdim e shohim se kemi një rrënje të këtij treguesi. Mirëpo siç mund të vërejmë në fund të vitit 2016 kemi një rritje të borxhit ndaj kapitalit të firmës edhe atë në nivelin 65% dhe kjo sinjalizon një shqetësim shtesë në aspekt të stabilitetit financiarë të biznesit.

Në vazhdim jepet një përmbledhje e treguesve financiarë të përlogaritur sipas rastit studimor dhe një vlerësim sipas mesatares në kuptim të krahasimit, dhe evidentimit të aspekteve për përmirësim të mëtejshëm.³²

³² Burimi i mesatares: <https://www.readyratios.com/sec/industry/C/>.

Tabela 23: Përmbledhja e treguesve financiar

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016	Mesatarja e industrisë
Raporti vijues	1.69	3.02	2.69	2.73	2.19	1.66
Norma e kesh-it	0.0036	0.0027	0.0801	0.0029	0.0147	0.27
Testi acid	0.0078	0.0081	0.6230	0.2534	0.5947	1.16
Fitimi marxhinal bruto	0.020	0.047	0.030	0.029	0.040	17.4%
Fitimi marxhinal neto	0.020	0.047	0.027	0.026	0.036	2.4%
Norma e kthimit të aktiveve (ROA)	0.0373	0.0796	0.0519	0.0500	0.0524	3.4%
Norma e kthimit të kapitalit (ROE)	0.0578	0.1039	0.0729	0.0712	0.0867	6.4%
Qarkullimi i inventarit	3.12	2.4	3.1	2.5	2.2	9
Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme	3.046	0	16.15	25.72	6.40	52
Qarkullimi i aktiveve gjithsej	1.9	1.7	1.9	1.9	1.4	289 ditë
Raporti i borxhit ndaj aktiveve	0.35	0.23	0.28	0.30	0.39	0.65
Raporti i borxhit ndaj kapitalit	0.55	0.30	0.40	0.42	0.65	1.09

4.2. Llogaritja dhe interpretimi i treguesve financiarë sipas klasifikimit tradicional

Meqenëse në pjesën paraprake të punimit u përlllogariten disa tregues financiarë sipas përzgjedhjes në kuadër të rastit studimor dhe periudhës së analizës, më tej vazhdohet me interpretimin e tyre.

Padyshim që analiza e treguesve financiarë në vete ngërthen përparësitë dhe kufizimet përkatëse, dhe disa prej tyre janë trajtuar më herët.³³

Analiza e treguesve financiarë ka një peshë të caktuar si nga perspektiva menaxheriale po ashtu edhe atë akademike. Për shembull, një studim me interes është artikulli i Vimrova (2015) i realizuar në rastin Republikës Çeke.³⁴

Gjithsesi duhet theksuar fakti se për qëllime dhe nevoja të menaxhmentit apo përdoruesve të informacionit financiarë përgjithësisht interpretimi mund të bëhet sipas klasifikimit tradicional (përfshirë përlllogaritjen) apo klasifikimit funksional. Andaj, në vazhdim analisti financiarë duhet të mbanë në konsideratë edhe specifikat, por edhe kufizimet gjatë interpretimit të rezultateve të përfituara.

Pra, përgjithësisht ekzistojnë dy mënyra-qasje në të cilat treguesit financiarë mund të klasifikohen, edhe atë në kuptimin (1) tradicional dhe (2) funksional.

Sipas klasifikimi tradicional treguesit klasifikohen si vijon:³⁵

Treguesit e humbjes dhe fitimit,

- 1) Treguesit e bilancit të gjendjes dhe
- 2) Treguesit e përbërë.

Për shembull, kur kemi dy variable nga bilanci i suksesit mund të llogaritet raporti i fitimit operativ si: Fitimi operativ / Shitjet neto dhe duke shumëzuar me 100 kalohet në rezultat si për qindje; ose raporti i marzhit të fitimit neto që llogaritet si: Fitimi neto / Shitjet.

³³ Për më shumë shih: Accounting Ratios – Accountancy: Company Accounts and Analysis of Financial Statements, <https://ncert.nic.in/ncerts/l/leac205.pdf>. [Online]

³⁴ Për më shumë shih: Hana Vimrova, Financial Analysis Tools, from Traditional Indicators through Contemporary Instruments to Complex Performance Measurement and Management Systems in the Czech Business Practice, 16th Annual Conference on Finance and Accounting, ACFA Prague, 2015, 29th May 2015. [Online]

³⁵ Accounting Ratios: Types of Ratios, <https://www.toppr.com/guides/accountancy/accounting-ratios/types-of-ratios/>. [Online]

4.3. Llogaritja dhe interpretimi i treguesve financiarë sipas klasifikimit funksional

Sipas klasifikimit funksional treguesit financiarë mund të grupohen apo klasifikohen duke marrë parasysh funksionin që ata luajnë. Ky është një klasifikim i treguesve më i saktë dhe më i dobishëm, dhe kështu më i përdoruri duke i klasifikuar ato si vijon:³⁶

- Raportet e likuiditetit,
- Raportet e levës,
- Raportet e aktivitetit,
- Raportet e profitabilitetit dhe
- Raportet e mbulimit.

Sigurisht që ky klasifikim nuk është i vetëm dhe diskutimet mandej mund të shtrihen duke u ndalur në çdo-nëngrup të këtyre klasifikimeve bazë. Për shembull, autori Manoj Shah treguesit financiarë sipas klasifikimit funksional i grupon ato në këtë pikëpamje:³⁷

- Raportet e profitabilitetit,
- Raportet e qarkullimit,
- Raportet e likuiditetit dhe
- Raportet e pronësisë.

Autori Manoj Shah më tej, bën klasifikimin e treguesve madje sipas përdoruesve të informacionit kontabël, edhe atë nga perspektiva e menxhmentit, kreditorëve dhe aksionarëve.

Sigurisht që çdo njëri prej tyre ka interesa dhe objektiva të caktuara andaj edhe ekzaminimi bashkë me klasifikimin do të jetë sipas nevojave që ato kanë.

Për shembull, rëndomë që menaxheri i firmës është i interesuar të dijë raportet e solvabilitetit, krahas raporteve të tjera. Po ashtu edhe kreditori është i interesuar të dijë për raportet e solvabilitetit të biznesit dhe kjo përfaqëson atë pikëprerjën e përdorimit dhe klasifikimit sipas këtyre dy përdoruesve.

³⁶ Accounting Ratios: Types of Ratios, <https://www.toppr.com/guides/accountancy/accounting-ratios/types-of-ratios/>. [Online]

³⁷ Manoj Shah, Ratio analysis, Module – III, Unit – II, http://content.inflibnet.ac.in/data-server/eacharya-documents/53e0c6cbe413016f234436f6_INFIEP_18/3/ET/18-3-ET-V1-S1__presentation_ra.pdf. [Online]

Gjithsesi që janë edhe disa tregues tjerë që përfaqësojnë interesa të përbashkëta ose perspektiva të përfaqëruara ekzaminuese si përdorues të informacionit kontabël.

Megjithatë, aksionarët do të ishin të interesuar për shembull për normën e dividentit, apo kthimin e kapitalit të matur përmes treguesve kryesor financiarë si: ROE, ROESF, apo të investigoj në strukturën fundamantale – skemën Du-Pont, etj. Por, gjithsesi edhe në këtë rast për shembull, skema apo analiza Du-Pont është çështje dhe objekt studimi edhe i menaxherit financiar.

Sigurisht, që klasifikimet e mësipërme mund të zërthehen në tregues dhe llogaritje madje mjaft analitike-specifike dhe kjo është në harmoni dhe kërkesë që përdoruesi apo vendimmarrësi parashtron në procesin e vendimmarrjes.

4.4. Analiza e bilancit tatimor dhe treguesit financiarë

Tatimi në fitim është formë tatimore e inkorporuar në sistemet tatimore të shumë shteteve bashkëkohore.³⁸

“Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas Ligjit të tatimit mbi fitim rregullohet mënyra e tatimit në fitim, shkalla sipas së cilës llogaritet tatimi mbi fitim, detyruesit për pagesë të tatimit mbi fitim, baza tatimore për llogaritje të tatimit mbi fitim, afatet për pagesën e tatimit mbi fitim, si dhe çështjet tjera të cilat janë të rëndësishme për përcaktimin dhe pagesën e tatimit mbi fitim etj.”³⁹

Më tej, “Detyruesit tatimor sipas sistemit tatimorë të RM-së së Veriut, janë të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga statusi i tyre juridik, pronësor dhe organizativ, do të thotë detyrues janë personat juridik rezident të RM-së edhe atë për fitimin e realizuar nga veprimtaria në vend dhe në botën e jashtme, si dhe personat juridik të huaj, të cilët kryejnë veprimtari të regjistruar, për fitimin e realizuar në territorin e RM-së”.⁴⁰

Përlllogaritja, detyrimi, respektivisht pagesa e tatimit në fitim gjithashtu duhet mbajtur parasysh nëpër llogaritjen e treguesve financiarë sepse i njëjti i influencon ato. Andaj, do të paraqesim tabelën në vijim që është një krahasim në mes fitimit apo humbjes sipas bilancit të suksesit dhe bilancit tatimor të firmës “Meti-Komerc” për vitin 2012-2016.

³⁸Abdylmenaf Bexheti, Financat Publike, 2007, fq. 173.

³⁹Për më shumë shih: Закон за данок на добивка, член 1, 2, “Службен весник на Република Македонија”.

⁴⁰Abdylmenaf Bexheti, Financat Publike, Tetovë 2007, fq. 174.

Tabela 24: Fitimi/humbja sipas bilancit të suksesit dhe bilancit tatimor

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Fitimi/humbja sipas bilancit të suksesit	316,253.00	754,620.00	634,961.00	667,104.00	889,954.00
Fitimi/humbja sipas bilancit tatimor	316,253.00	754,620.00	26,877.00	45,962.00	22,285.00
<i>Diferenca</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>608,084.00</i>	<i>621,142.00</i>	<i>867,669.00</i>




Figura 24: Fitimi/humbja sipas bilancit të suksesit dhe bilancit tatimor

Nga analiza e bilancit tatimorë shihet që në vitin 2012 dhe 2013 nuk ka diferencë në mes asaj që është përlogaritur në bilancin e suksesit kundrejt bilancit tatimor, ndërsa në periudhën 2014 – 2016 diferenca është evidentuar në kuptim që bilanci tatimor tregon më pak fitim.

Diferenca e evidentuar që rezulton padyshim që do të kishin efekt edhe treguesit financiarë, sidomos ata që lidhen me profitabilitetin (ndryshimet nga shkak i rritjes së shpenzimeve të papranuara– shpenzimet të cilat nuk pranohen në bilancin tatimorë dhe formojnë bazën tatimore).

Padyshim që rezultati do të ndryshonte në përlogaritjen qoftë të ROA-s ose ROE-s kur përdoret për shembull, fitimi prej 889,954 denarë në vitin 2016 në krahasim me 22,285 denarë sipas bilancit tatimor.

4.5. Të dhënat dhe interpretimi i informacionit nga gjetjet e pyetësorit

Në vazhdim, të dhënat dhe grumbullimi i informacioneve në lidhje me ecurinë e firmës janë siguruar edhe nëpërmjet pyetësorit i cili është realizuar drejtpërdrejt me personat përgjegjës të firmës “Meti-Komerc”.

Hartimi i pyetësorit është i ndarë në dy pjesë: tek pjesa e parë është siguruar informacion për aktivitetin e ushtruar nga ana e personave përgjegjës, pozita e tyre në firmë, niveli i edukimit të tyre, profesioni i tyre etj. Ndërsa tek pjesa e dytë pyetësi është ndërtuar në atë mënyrë që të marrim përgjigje në lidhje me pasqyrat financiare: a janë të informuar me konceptin kontabilitet, a kanë pasur rast të përdorin bilancet e firmës, si pjesë e ekipit menaxhues a janë të vetëdijshëm për përparësitë dhe mangësitë e treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste etj.

Në qendër të këtij punimi kryesisht ka qenë se a i ka përdorur firma treguesit financiarë në marrjen e vendimeve si dhe matjen, analizën dhe vlerësimin e gjendjes/performancës financiare, dhe si kanë ndikuar ato në vendimmarrjen afariste gjatë periudhës 2012-2016 në funksion të përmirësimit të tyre.

Pyetjet bazë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për testimin, analizën dhe verifikimin e hipotezave të cilat janë parashtruar në pyetësor pritet të shërbejnë për orientim dhe dhënie përgjigje/zbërthim të objektivave hulumtuese.

Marrja e të dhënave – informacioneve është siguruar kryesisht me ballafaqimin direkt me personat përgjegjës të firmës dhe me të punësuarit.

Pyetësi fillon me pyetjet që kanë të bëjnë me nivelin e arsimimit duke vazhduar me informatat në lidhje me profesionin dhe pozitat e tyre në firmë (pyetja 1, 2, 3) dhe rezultatet janë si vijon:

Tabela 25: Të dhënat e siguruar për nivelin e arsimimit, profesionit dhe pozitën e tyre

Niveli i arsimimit, profesioni dhe pozita e tyre	Të punësuarit e shprehur në numër
I lartë	2
I mesëm	4
I ulët	9
Gjithsej	15




Figura 25: Paraqitja grafike e nivelit të arsimimit, profesionit dhe pozita e tyre

Sa i takon nivelit arsimor të intervistuarve mund të themi se në bazë të përgjigjeve të marra vetëm 2 persona kanë kryer arsimimin e lartë edhe atë, personi i cili është përgjegjës për punët financiare të firmës si dhe firma ka të punësuar edhe një inxhinier, vetëm katër të punësuar e kanë të kryer shkollën e mesme ekonomike, ndërsa pesë të punësuarit e tjerë kanë të kryer vetëm shkollën fillore. Këtu vlen të ceket se ka mungesë të gjeneratës së re me nivel të lartë të arsimimit dhe kjo ngelët sfidë për firmën.

Pyetja në vazhdim ka të bëjë me përvojën e të punësuarve në firmë (pyetja e 4) dhe rezultatet janë:

Tabela 26: Përvoja e të punësuarve

Përvoja e të punësuarëve	Të punësuarit e shprehur në numër
Më pak se 1 vit	2
1 – 5 vite	5
Më tepër se 5 vite	8
Gjithsej	15




Figura 26: Përvoja e të punësuarve

Në bazë të përgjigjeve të marra kemi konstatuar se numri i të punësuarve të cilët kanë punuar më pak se 1 vit ka qenë 2, të punësuarit të cilët kanë punuar në periudhë kohore 1 - 5 vite është gjithsej 5, si dhe të punësuarit në firmë me përvojë të punës më tepër se 5 vite janë gjithsej 8.

Pjesa kryesore në vazhdim të pyetësorit është bazuar pikërisht në marrjen e informacionit se a janë të informuar për konceptin kontabilitet dhe a kanë pasur raste të përdorin bilancet e firmës (pyetja 5 dhe 6).

Tabela 27: Njoha e konceptit të kontabilitet dhe përdorimi i bilanceve

Informimi për konceptin kontabilitet dhe përdorimi i bilanceve të firmës	Të punësuarit e shprehur në numër
Po	5
Jo	10
Gjithsej	15




Figura 27: Paraqitja grafike për nocionin e kontabilitet dhe përdorimin e bilanceve

Nga përgjigjet e marra kemi konstatuar se personat përgjegjës të firmës, drejtori, menaxheri si dhe të punësuarit e firmës janë përgjigjur me “Po” pyetjes se a kanë njohuri për konceptin e kontabilitet dhe përdorimin e bilanceve të firmës. Pra, të njëjtit kanë qenë të mirë informuar për këtë nocion, ndërsa 10 të punësuarit e tjerë janë përgjigjur me pyetjet se nuk kanë pasur raste të përdorin bilancet e firmës ngase disa prej tyre janë të angazhuar vetëm në punët e ndërtimtarisë, disa të tjerë realizojnë aktivitetet e tjera të firmës si punët e transportit, shitjes së materialeve për ndërtim etj.

Më tej, nga realizimi i pyetësorit kemi konstatuar se nga gjithsej 15 të anketuar, vetëm 3 persona janë përgjigjur pyetjes nr. 7 (që korrespondojnë me përgjigjet e pyetjes nr. 8) me “Po”, ndërsa 12 të anketuar të tjerë janë përgjigjur me “Jo”. Pra, 12 të anketuar nuk kanë pasur njohuri për përparësitë dhe mangësitë e treguesve financiarë si dhe nuk kanë pasur rast në përdorimin e tyre. Pikërisht ato të cilët kanë njohuri dhe janë të vetëdijshëm për treguesit financiarë edhe i kanë përdorur përgjithësisht në vendimmarrjen afariste.

Tabela 28: Përparësitë e treguesve financiarë dhe përdorimi i tyre

Njohuri për përparësitë e treguesve financiarë dhe a i kanë përdorur treguesit financiar	Të punësuarit e shprehur në numër
Po	3
Jo	12
Gjithsej	15




Figura 28: Njohja e treguesve financiarë dhe përdorimi e tyre

Në vazhdim, në pyetjen nr. 8 nëse e kanë përdorur analizën e treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste, përgjigjet e fituara tregojnë se vetëm 3 të punësuar (të anketuarit) janë përgjigjur me “Po”, ndërsa të anketuarit e tjerë janë përgjigjur me “Jo”.

Rezultatet e kësaj pyetje nxjerrin në sipërfaqe se megjithatë një pjesë e vogël e të punësuarve në rolin e vendimmarrësit i shfrytëzojnë treguesit financiarë. Kjo do të thotë se personat përgjegjës të firmës apo ekipi menaxhues i firmës kryesisht kanë njohuri për kontabilitetin, treguesit dhe performancën/gjendjen e firmës.

Tabela 29: Përdorimi i treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste

A e kanë përdorur analizën e treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste	Të punësuarit e shprehur në numër
Po	3
Jo	12
Gjithsej	15



Figura 29: Përdorimi i treguesve financiarë në vendimmarrjen afariste

Në vazhdim, ashtu siç e kemi cekur edhe më lartë se për të pasur një pasqyrë më reale të gjendjes dhe performancës financiare të firmës janë realizuar analizat e mirënjohura në fushën e pasqyrave financiare dhe rezultatet u prezantuan.

Por, njëkohësisht është realizuar edhe një pyetësor (shumica e rezultateve u prezantuan) me të punësuarit me gjithë kufizimet që ai mund të ketë. Qëllimi është kryqëzimi i informacionit kontabël me përdorimin praktik të tij dhe sidomos nga ekipi menaxhues i firmës si përdorues të brendshëm.

Andaj, të dhënat e analizuar treguan se megjithatë performanca financiare shprehur përmes dy treguesve kryesorë ROA dhe ROE ka një trend përgjithësisht të përmirësuar (shih tabelën dhe figurën në vazhdim sipas krahasimit 2012 – 2016).

Tabela 30: Norma e kthimit të aktiveve dhe kapitalit (ROA dhe ROE)

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Fitimi neto	316,253.00	754,620.00	571,465.00	600,394.00	800,959.00
Aktivet	8,476,945.00	9,474,235.00	11,008,785.00	11,990,719.00	15,258,691.00
Kapitali	5,465,688.00	7,260,308.00	7,831,773.00	8,432,167.00	9,233,126.00
ROA	3.73 %	7.96 %	5.19 %	5 %	5.24 %
ROE	5.78 %	10.39 %	7.29 %	7.12 %	8.67 %




Figura 30: Norma e kthimit të kapitalit (ROE) dhe norma e kthimit të aktiveve (ROA)

Siç mund të prezantohet (shih Tabelën 30) fitimi neto pas tatimit në vitin 2012 ka qenë 316,253.00 denarë, ndërsa në vitin 2016 shënon 800,959.00 denarë. Pra, evidentohet një trend rritës dhe që konfirmohet edhe përmes dy treguesve financiarë ROA dhe ROE.

Norma e kthimit të aktiveve (ROA) ka pasur trend rritëse edhe atë: në vitin 2012 norma e kthimit të aktiveve ka qenë 3.73%, në vitin 2013 7.96%, ndërsa në vitet në vazhdim 2014, 2015 dhe 2016 ka qenë 5.19%, 5% dhe 5.24%.

Në anën tjetër, norma e kthimit të kapitalit (ROE) në vitin 2012 ka qenë 5.78%, në vitin 2013 shënon 10.39%, në vitin 2014, 2015 dhe 2016 ky tregues ka qenë 7.29%, 7.12% dhe 8.67%.

Tani çështja është hulumtuar nëse ky trend është evidentuar ose së paku perceptuar nga të punësuarit dhe rezultatet janë si në vijim (shih në vazhdim rezultatet nga pyetja 9 dhe 10 lidhur me perceptimin e gjendjes dhe performancës financiare)

Tabela 31: Perceptimi për gjendjen/performancën e firmës

A është përmirësuar apo përkeqësuar performanca e firmës	Të punësuarit e shprehur në numër
Po	12
Jo	3
Gjithsej	15



Figura 31: Paraqitja grafike për gjendjen/performancën

Andaj, rezultatet e fituara tregojnë se nga ana e personave përgjegjës të firmës (pavarësisht nivelit të menaxhimit dhe punës që ato realizojnë), megjithatë gjendja dhe performanca konceptohen pozitive, edhe atë nga gjithsej 15 të anketuar 12 prej tyre janë përgjigjur pyetjes me “Po”, ndërsa 3 prej tyre janë përgjigjur pyetjes me “Jo”.

Rezultatet në mënyrë të përmbledhur hedhin dritë në atë se është pikërisht menaxheri dhe pronari i firmës ata që janë të interesuar për ecurinë e biznesit dhe njëkohësisht për informacionin financiarë. Sidomos përgjigjet e pyetjeve 7 – 10 tregojnë se megjithatë ekipi menaxhues i firmës (në kuptimin më të drejtpërdrejt menaxhues) është i interesuar – vetëdijshëm për përparësitë që analiza e treguesve financiar ka në vendimmarrjen afariste dhe se e kanë përdorur analizën e treguesve financiarë si mjet në vendimmarrjen afariste gjatë periudhës 2012-2016.

Më tej, ekipi menaxhues përgjithësisht mendon se gjendja dhe performanca financiare e kompanisë “Meti Komerc” gjatë periudhës 2012-2016 është përmirësuar. Megjithatë, analiza e pyetësorit tregoi se leximi apo përdorimi i treguesve financiarë bëhet kryesisht në nivel vjetor nga ana e ekipit menaxhues të firmës.

4.6. Analiza me skenar dhe implikimi në vendimmarrjen menaxheriale

Meqenëse disponohet informacion jo i plotë për të realizuar një analizë të mirëfilltë, krahasimi dhe skenarët ndërtohen kryesisht në nivelin e financimit të biznesit. Ideja bazë është se borxhi shënon rritje në strukturën e kapitalit. Andaj, krahas përlogaritjes dhe diskutimit të treguesve financiarë për vlerësimin e gjendjes/performancës financiare që e kemi bërë më lartë, ne do të mundohemi të shpjegojmë strukturën e kapitalit të firmës edhe atë nëpërmjet analizës me skenarë.

Mirëpo duke pasur parasysh mundësit e shlyerjes së borxhit pikë së pari duhet t’u kushtojmë një vëmendje e posaçme treguesve të likuiditetit dhe treguesve të rentabilitetit. Fillimisht për të pasur një pasqyrë më reale ri-radhitim rezultatet e fituara si në vijim që lidhen me strukturën e kapitalit të firmës.

- Në vitin 2012 firma “Meti - Komerc” ka 8,476,945.00 denarë aktive gjithsej dhe struktura e kapitalit të firmës përbëhet nga 64.5% nga kapital dhe 35.5% borxh.
- Në vitin 2013 firma Meti- Komerc ka aktive gjithsej prej 9,474,235.00 denarë, struktura e kapitalit të firmës përbëhet nga 23% borxh dhe 77% kapital.
- Në vitin 2014 firma “Meti-Komerc” ka aktive prej 11,008,785.00 denarë, struktura e kapitalit të firmës përbëhet prej 71% kapital dhe 29% borxh.
- Në vitin 2015 firma “Meti- Komerc” ka aktive prej 11,990,719.00 denarë, struktura e kapitalit përbëhet 70% kapital dhe 30% borxh.
- Në vitin 2016 firma “Meti- Komerc” ka aktive prej 15,258,691.00, struktura e kapitalit të firmës përbëhet nga 60.5% kapital dhe 39.5% borxh.

Për të vlerësuar dhe interpretuar (analiza me skenarë) se si do jetë struktura e kapitalit në qoftë se firma nuk do kishte kredi (borxh financiar), do të interpretohet nëpërmjet treguesve si ROA si dhe nivelit të borxhit ndaj aktiveve dhe nivelit të borxhit ndaj kapitalit.

Tabela 32: Disa zëra bilancor nga bilanci i suksesit

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Fitimi operativ	15,799,199.00	15,932,944.00	20,891,326.00	22,465,936.00	21,715,984.00
Shpenzimet operative	15,482,946.00	15,178,324.00	20,146,714.00	21,730,994.00	20,736,568.00
Fitimi para tatimit	316,253.00	754,620.00	634,961.00	667,104.00	889,954.00
Tatimi në fitim	0.00	0.00	63,496.00	66,710.00	88,995.00
Fitimi neto	316,253.00	754,620.00	571,465.00	600,394.00	800,959.00
Kthimi mbi kapitalin ROE	5.7%	10.39%	7.29%	7.12%	8.67%

Në vitin 2012 firma ka marrë një kredi në vlerë prej 1,116,000.00 denarë, borxhi mbi aktivet gjithsej është 0.355 dhe raporti i borxhit ndaj kapitalit është 0.55. Në këtë vit firma nuk ka pasur shpenzime interesi dhe leva financiare është: $0.0578 / 0.0373 = 1.54$ Në kushtet (analiza me skenarë) në qoftë se firma nuk do merrte kredi në këtë rast do kishim këtë gjendje:

Detyrimet e zvogëluara nga 3.011.257.00 në 1,779,748.00.

$1,799,748.00 + 5,465,688.00 = 7,245,436.00$ gjithsej pasiva. Në këtë rast do të ishte edhe aktiva e firmës si:

$$8,476,945.00 - 616,000.00 = 7,245,436.00$$

Më tej, Të ardhurat operative – Shpenzimet operative = Fitimi neto

$$15,799,199.00 - 15,482,946.00 = 316,253.00$$

$$ROA = 316,253.00 / 7,245,436.00 = 4.36\%$$

Në këtë rast do kishim një ndryshim në ROA edhe atë nga 3.73 % në 4.36 %.

$$\text{Raporti i borxhit ndaj aktiveve} = 1,779,748.00 / 7,245,436.00 = 0.245.$$

$$\text{Raporti i borxhit ndaj kapitalit} = 1,779,748.00 / 5,465,688.00 = 0.32.$$

Pra nga analiza me skenar e shohim se raporti i borxhit ndaj aktiveve është zvogëluar nga 0.355 në 0.245, po ashtu edhe raporti i borxhit ndaj kapitalit është zvogëluar në 0.32 nga 0.550

Viti 2013: Rritja në kthimin mbi kapitalin rezulton nga fitimi operativ. Leva financiare është: $0.1039 / 0.0796 = 1.30$. Në bazë të llogaritjes së levës financiare ne mund të shohim se leva financiare është më e madhe se 1, që tregon se kthim mbi kapitalin e vet tejkalon kthimin mbi aktivet, kjo do të thotë që firma po përdor borxhin e saj me përfitim. Në këtë vit firma ka marrë kredi në vlerë prej 616,000.00 denarë. Në qoftë se nuk do kishte marrë kredi si do ishte gjendja?

Pra, kemi: Detyrimet afatshkurtra – kreditë = detyrime gjithsej.

$$2,213,927.00 - 616,000.00 = 1,420,260 \text{ detyrime gjithsej.}$$

$$\text{Pasiva do të ishte: } 1,420,260.00 + 7,260,308.00 = 8,680,568.00.$$

$$\text{Aktiva do të ishte: } 9,474,235.00 - 793,667.00 = 8,680,568.00.$$

$$\text{ROA do të ishte: } 754,620.00 / 8,680,568.00 = 8.6\%.$$

Kemi rritje të ROA edhe atë nga 7.96% në 8.6%.

$$\text{Raporti i borxhit ndaj aktiveve} = 1,420,260.00 / 8,680,568.00 = 0.16.$$

$$\text{Raporti i borxhit ndaj kapitalit} = 1,420,260.00 / 7,260,308.00 = 0.19.$$

Sipas analizës më skenar raporti i borxhit ndaj aktiveve është zvogëluar nga 0.233 në 0.16 dhe raporti i borxhit ndaj kapitalit gjithashtu është zvogëluar në 0.19 nga 0.304.

Viti 2014: Nëse krahasojmë ROE e vitit paraprak me vitin 2014 e shohim se është në rënie për 3%. Shpenzimet e interesit në këtë vit kanë qenë 109,256.00. Atëherë, në qofte se firma nuk do kishte marrë kredi sa do të ishte ROA?

Detyrimet afatshkurta – kreditë = detyrimet gjithsej.

$$3,177,012 - 616,000.00 = 2,561,012.00.$$

Detyrimet gjithsej + kapitali = pasiva gjithsej.

$$2,561,012.00 + 7,831,773.00 = 10,392,785.00 \text{ pasiva gjithsej}$$

$$\text{Aktiva do të ishte: } 11,008,785.00 - 616,000.00 = 10,392,785.$$

$$\text{ROA: } 571,465.00 / 10,392,785.00 = 5.49\%.$$

Kemi rritje të ROA-s nga 5.19% në 5.49%.

$$\text{Raporti i borxhit ndaj aktiveve: } 2,561,012.00 / 10,392,785.00 = 0.25.$$

Raporti i borxhit ndaj aktiveve të firmës është zvogëluar nga 0.288 në 0.25.

$$\text{Raporti i borxhit ndaj kapitalit} = 2,561,012.00 / 7,831,773.00 = 0.32.$$

Viti 2015: Edhe në vitin 2015 firma ka marrë një kredi në vlerë prej 1,591,253.00. Shpenzimet e interesit në këtë vit krahasuar me vitin paraprak janë më të vogla edhe atë në vlerë prej 67,838.00. Nëse firma nuk do kishte marrë kredi sa do të ishte ROA?

Detyrimet afatshkurtra – kreditë = detyrime gjithsej

$$3,558,552 - 1,591,253.00 = 1,967,299.00.$$

Detyrimet gjithsej + kapitali = pasiva gjithsej.

$$1,967,299.00 + 8,432,167.00 = 10,399,466.00.$$

$$\text{Aktiva do të jetë: } 11,990,719 - 1,591,253.00 = 10,399,466.00.$$

ROA: $600,394.00 / 10,399,466.00 = 5.77 \%$.

ROA ka qenë 5.0% dhe është rritur në 5.7%

Raporti i borxhit ndaj aktiveve: $1,967,299.00 / 10,399,466.00 = 0.19$.

Raporti i borxhit ndaj kapitalit = $1,967,299.00 // 8,432,167.00 = 0.23$.

Raporti i borxhit ndaj aktiveve është zvogëluar nga 0.296 në 0.19, po ashtu edhe raporti i borxhit ndaj kapitalit është zvogëluar nga 0.422 në 0.23.

Viti 2016: Edhe në vitin 2016 firma ka marrë një kredi në vlerë prej 2,261,000.00 denarë. Shpenzimet e interesit në këtë vit kanë qenë 87,002.00. Atëherë në qoftë se i zbresim shpenzimet e interesit nga fitimi operativ të tregohet sa do të jetë ROA?

Detyrimet afatshkurtra – kreditë = detyrime gjithsej.

$6,025,565 - 2,261,000.00 = 3,764,565.00$.

Detyrimet gjithsej + kapitali = pasiva gjithsej.

$3,764,565.00 + 9,233,126.00 = 12,997,691.00$.

Aktiva: $15,258,691.00 - 2,261,000.00 = 12,997,691.00$.

ROA: $800,959.00 / 12,997,691.00 = 6.16\%$.

Kemi rritje të ROA-s edhe atë nga 5.24% në 6.16%.

Borxhi mbi aktivet gjithsej: $3,764,565.00 / 12,997,691 = 0.29$.

Raporti i borxhit ndaj kapitalit: $3,764,565.00 / 9,233,126.00 = 0.40$.

Raporti i borxhit ndaj aktiveve është zvogëluar nga 0.394 në 0.29, si dhe raporti i borxhit ndaj kapitali është zvogëluar nga 0.652 në 0.40.

Simulimi me kufizimet e përcjella jep një indikacion që firma duhet të jetë e kujdesshme në drejtim të përdorimit të borxhit financiar. Çështja që ngrihet dhe për analiza të mëtejshme dhe më të avancuara është sesi të plotësohet vendi i borxhit në kuadër të miksit borxh-kapital.

Një implikim tjetër menaxherial është nëse firma do të ishte në gjendje t'i realizon të njëjtit tregues financiar dhe sidomos ata që lidhen me likuiditetin dhe përfitueshmërinë nëse nuk do të financohej me kredi bankare. Pra, cili do të ishte zëvendësuesi i këtij burimi financues është pyetja bazë.

4.7. Përmbledhje, diskutimi dhe implikimi praktik i rezultateve

Në këtë pjesë të punimit do të bëhet përmbledhja gjetjeve – rezultateve të arritura më lartë kryesisht për t’i verifikuar hipotezat si dhe implikimi praktik i tyre.

Analiza horizontale, vertikale dhe analiza e treguesve financiarë janë pikërisht teknikat të cilat janë përdorur në këtë punim për analizën e gjendjes/performancës financiare të firmës “Meti-Komerc” për periudhën 2012-2016 dhe do shërbejnë si bazë referimi në nxjerrjen e përfundimeve dhe marrjen e vendimeve.

Në vazhdim, do të diskutohen analizat e kryera për të pasur një pasqyrë më të mirë dhe për të nxjerr konkluzione nga më të ndryshme për ecurinë e firmës si dhe sfidat me të cilat është ballafaquar kjo firmë. Po ashtu ky punim përpiket t’i ofrojë ekipit menaxhues një mundësi për të kuptuar rolin që ka analiza e treguesve financiarë në marrjen e vendimeve menaxheriale si dhe ndikimin e tyre në gjendjen dhe performancën financiare. Përnjëherë përmes dhënies së disa sugjerimeve edhe për përmirësim të gjendjes dhe performancës financiare.

Nga analiza strukturore e bilancit të gjendjes mund të tregojmë strukturën e aktiveve dhe pasiveve të firmës. Likuiditeti i firmës gjatë viteve 2012-2016 është përgjithësisht i mirë duke i parë se aktivet afatshkurtra të firmës janë më të larta në krahasim me detyrimet afatshkurtra (Tabela 2).

Lidhja midis aktiveve afatshkurtra dhe detyrimeve afatshkurtra: në vitin 2012 aktivet afatshkurtra përbëjnë 60% të aktiveve gjithsej, ndërsa detyrimet afatshkurtra përbëjnë 35% të pasives (Tabela 2). Kjo nënkupton që likuiditeti i firmës është përgjithësisht i mirë. Situata është e njëjtë edhe në vitet në vazhdim ku vërejmë pasi aktivet afatshkurtra janë rritur nga 70% në 78% në vitin 2014, ndërsa detyrimet afatshkurtra janë rritur në 29% nga 23% (Tabela 2). Edhe më tej aktivet afatshkurtra të firmës janë rritur në 87% nga 79%. Po ashtu rritje kemi edhe te detyrimet afatshkurtra nga 30% në 39% (Tabela 2).

Vlen të theksojmë se aktivet afatshkurtra të firmës janë gjithmonë në rritje, ku vlera më e ulët e tyre në vitin 2012 ka qenë 60% e aktiveve gjithsej, ndërsa vlera më e lartë ka qenë në vitin 2016 edhe atë 87% e aktiveve gjithsej (Tabela 3).

Në analizën dinamike të bilancit të gjendjes aktivet afatgjata të firmës në vitin 2013 me vitin 2012 janë zvogëluar për 18% (Tabela 4), ndërsa në vazhdim në vitet 2014 me vitin 2013 aktivet afatgjata përsëri janë zvogëluar për 11% (Tabela 4). Në vitet 2015 dhe 2014 e shohim se aktivet afatgjata përsëri janë në rënie edhe atë për 8% (Tabela 4). Si dhe krahasimi i viteve të

fundit 2016 me vitin 2015 aktivet afatgjata janë zvogëluar për 11% (Tabela 4). Arsyeja se pse kemi rritje të aktiveve afatgjata është pikërisht shkaku i zvogëlimit të mjeteve materiale të cilat e përbëjnë pjesën më të madhe të aktiveve afatgjata si dhe vjetërsimi i mjeteve të punës të cilat me kalimin e kohës janë zhvlerësuar.

Ndërsa tek aktivet afatshkurtra të firmës ka ndodhur e kundërta ato gjithnjë janë në rritje. Në vitin 2012 në krahasim me vitin 2013 aktivet afatshkurtra janë rritur për 32%, ndërsa detyrimet afatshkurtra në vitin 2012 në krahasim me vitin 2013 janë zvogëluar për 26% (Tabela 4).

Në vitin 2014 në krahasim me vitin 2013 aktivet afatshkurtra janë rritur për 28%, ndërsa detyrimet afatshkurtra janë rritur për 44%, ku mund të themi se likuiditetit i firmës ka rënë (Tabela 4).

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014 aktivet afatshkurtra të firmës janë rritur për 14%, ndërsa detyrimet afatshkurtra janë rritur për 12% (Tabela 4).

Në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 aktivet afatshkurtra të firmës janë rritur për 36%, ndërsa detyrimet afatshkurtra janë rritur për 69%, ku mund të themi se likuiditeti i firmës është përkeqësuar (Tabela 4).

Ndërsa, nëse e krahasojmë kapitalin e firmës në vitin 2013 me vitin 2012 është në rritje për 33% (Tabela 4), ndërsa nëse e vërejmë fitimin neto është në rritje për 138% (Tabela 9). Nëse i krahasojmë vitet 2013 me 2014 kapitalit dhe rezervat shënojnë rritjepër 8% (Tabela 4), ndërsa fitimi neto është në rënie për 24 % (Tabela 9).

Në vitin 2015 me vitin 2014 kapitali dhe rezervat janë në rritje për 8% (Tabela 4), ndërsa fitimi neto është në rritje për 5% (Tabela 9). Si dhe krahasimi i vitit të fundit 2016 me 2015 kapitali dhe rezervat janë në rritje për 10% (Tabela 4), ndërsa fitimi neto është në rritje për 33% (Tabela 9).

Nga ana tjetër nëse analizojmë strukturën e kapitalit dhe detyrimeve mund të konstatojmë se kemi gjithnjë rritje të kapitalit dhe rezervave, ndërsa kemi një luhatje të vogël të detyrimeve. Viti me nivel më të lartë të kapitalit dhe rezervave ka qenë viti 2013 me 77% e pasivës, ndërsa detyrimet kanë qenë 23% (Tabela 2), si dhe në vitin 2014 ku kapitali dhe rezervat përbëjnë 71% të pasivës dhe detyrimet 29%.

Më tej, në bilancin e suksesit mund të vërejmë luhatjen e fitimit neto nga 2% në 5% në vitin 2013 dhe kjo vjen si pasojë e ndryshimit në të hyrat dhe shpenzimet e firmës (shih Tabelën

7). Megjithatë, në vitin 2014 fitimi neto shënon rritje vetëm për 3% për shkak të rritjes së shpenzimeve operative në 96.44%. Në fund të vitit 2016 firma ka shënuar një rritje të fitimit neto për 3.68% si dhe shpenzimet kanë qenë 95.48% (Tabela 7).

Në anën tjetër, në kuadër të analizës së firmës janë llogaritur treguesit financiarë që janë domethënës në kuptim të vendimmarrjes dhe për të kuptuar më saktë ecurinë e biznesit. Analiza e treguesve financiarë mes gjetjeve të tjera nxjerrë edhe implikimet vijuese menaxheriale dhe praktike si vijon.

Raporti vijues i firmës gjatë viteve ka qenë përgjithësisht i mirë, edhe atë në vitin 2012 aktivet afatshkurtra mbulonin detyrimet afatshkurtra me 1.69 herë dhe pastaj në vitin 2013 kemi rritje të treguesit – koeficientit në 3.02 herë. Po ashtu edhe në vitet e tjera ky raport ka qenë pozitiv që do të thotë se firma i ka harmonizuar mirë politikat menaxhuese të aktiveve afatshkurtra me detyrimet afatshkurtra. Andaj, themi se kapitali punues i firmës ka vlera pozitive, pra është rritur.

Sipas analizës së normës së kesh-it mund të konstatojmë se firma në vitin 2013 ka një rrënjë të këtij koeficienti, ku më pas kemi një rritje në vitin 2014. Pastaj ka vazhduar me rrënjë dhe kjo implikon se firma nuk mund të mbështetet në parat e sajë nga aktivitetet operative për t'i mbuluar detyrimet e saj rrjedhëse – aktuale.

Në anën tjetër, si tregues më i saktë për të matur likuiditetin e firmës është testi acid sepse ky tregues i merrë parasysh vetëm aktivet më likuide të firmës. Siç u tregua edhe nga analiza e bërë vlera e këtij treguesi është më e ulët. Gjendja e likuiditetit të vitit 2012 dhe 2013 është e ulët. Në të gjitha vitet tjera ky tregues është përsëri i ulët, pra është nën 1 që implikon se firma ka investuar më shumë në inventarë.

Qarkullimi i inventarit dhe qarkullimi i llogarive të arkëtueshme – nga rezultatet e fituara ne mund të themi se këto dy tregues kanë përjetuar ulje ngritje sipas viteve të analizës, por që përgjithësisht janë të pranuar duke marrë në konsideratë edhe ndryshimet apo aktivitetet e realizuara brenda firmës.

Raporti i qarkullimi të aktiveve – siç u dëshmuar ky raport ka qenë mbi 1, përgjithësisht i pranueshëm duke marrë në konsideratë edhe investimin në aktive dhe që është i lartë në krahasimin fillim dhe përfundim i periudhës së analizës.

Fitimi marginal bruto – rezultatet e fituara nga analiza tregojnë se në vitet 2012, 2014 dhe 2015 treguesi në fjalë është i ulët pra 2%, 3% dhe 2.9%. Në vitin e fundit ka filluar të rritet dhe ka arritur 4% që tregon një përmirësim të vogël.

Fitimi marginal neto – edhe të ky raport rezultatet pothuajse janë të njëjtë dhe kuptohet pak më i ulët nga fitimi marginal bruto, sepse ky tregues e merrë parasysh tatimin në fitim.

Norma e kthimit të aktiveve – në fillim të vitit ky raport ka qenë 3.73%, ndërsa në vitet në vijim ky tregues është rritur edhe atë arrinë në 8%. Po ashtu, edhe në vitet e fundit norma e kthimit nga aktivet ka qenë 5%. Mund të themi se sipas rezultateve të fituar kemi një rritje të konsiderueshme sa i përket këtij treguesi që është një indikator i suksesit për firmën.

Kthimi nga kapitali – nga analiza e bërë tregohet se ky tregues ka shënuar një rritje të konsiderueshme dhe është pikërisht ajo çfarë menaxheri, dhe kryesisht drejtori – pronari pretë nga biznesi.

Raporti i borxhit ndaj aktiveve –siç mund të vërejmë nga analiza e bërë borxhi ka lëvizur në shuma të ndryshme nga viti në vit. Shuma më e lartë e borxhit ka qenë në vitin 2016, edhe atë me 39%, ndërsa më e ulët në vitin 2013 me 23%.

Raporti i borxhit ndaj kapitalit – nëpërmjet këtij raporti u tregua se në vitin 2012 është arritur rezultati prej 55%, ndërsa në vitet në vazhdim kemi pasur një rrënje edhe atë viti 2013 30%, 40 % viti 2014 si dhe vitet e fundit e vërejmë një tendencë rritëse të borxhit ndaj kapitalit të firmës edhe atë për 65%.

Kapitulli i 5. Përfundime, rekomandime dhe kufizimet e studimit

5.1 Përfundime dhe rekomandime

Në përfundimin e këtij punimi i kemi paraqitur disa rekomandime si metodologjike ashtu edhe për firmën në përmirësimin e pozicionit dhe performancës financiare të saj e matur dhe e sugjeruar nëpërmjet analizave të ndryshme, përfshirë edhe atë të treguesve financiarë.

Marrë në përgjithësi firma “Meti-Komerc” ka arritur të mbanë një pozicion likuid në periudhën 2012-2016 (hipoteza 1) dhe kjo u prezantua përmes matjeve të caktuara – treguesve si ai i likuiditetit-vijues (trendi pozitiv i shprehur me ekuacionin: $y = 0.071x + 2.251$), norma e keshit (trendi pozitiv i shprehur me ekuacionin: $y = 0.0022x + 0.0141$) etj.

Megjithatë, analizuar si trend ngel shqetësues fakti i përkeqësimit në disa zëra bilancor dhe bllokimit të parasë si likuiditet. Kryesisht në pozicionin e inventarëve që u dëshmuar edhe përmes analizave (trendi negativ i qarkullimit të inventarëve i shprehur me ekuacionin: $y = -0.174x + 3.186$) ku raporti mesatar vijues arrijnë 2.7 herë kundrejt testit acid mesatar prej 0.3. Dallimi kaq i shprehur në mes këtyre dy treguesve dëshmon nivelin e lartë të inventarëve që firma ka dhe investimi konkret në inventarë ngelë çështje për analizë të mëtejshme.

Më tej, përdorimi më efikas dhe efektiv i aktiveve do të përmirësonte edhe më shumë treguesit financiarë, kryesisht ato që lidhen me përfitueshmërinë. Fitimi marginal bruto dhe neto shënojnë trend rritës (hipoteza 2), por kuptohet që të njëjtit përmes një menaxhimi ende më të saktë mund të përmirësohen duke përmirësuar njëkohësisht edhe dy treguesit kryesor si ROA dhe ROE. Ndonëse të njëjtit sa vijnë edhe përmirësohen, për shembull, ROE në vitin e fundit arrijnë në 9% në krahasim me 6% vitin e parë të analizës.

Në aspekt të financimit, firma në fjalë gjatë periudhës së analizës përdor kryesisht kapitalin dhe aktivet janë financuar mesatarisht me 31% detyrime. Kjo do të thotë se çdo 1,000 denarë aktive financohet me 310 denarë detyrime. Megjithatë, rekomandohet që firma të jetë e kujdesshme në aspekt të përdorimit të borxhit financiarë, respektivisht kredisë bankare.

Së fundi, rezultatet nga analiza e pyetësori tregoi se megjithatë marrë në përgjithësi menaxhmenti i firmës është i njoftuar për rëndësinë e informacionit kontabël dhe financiar në vendimmarrje (hipoteza 3). Shqetësues është fakti se informacioni dhe treguesit financiarë përdoren kryesisht në nivel vjetor. Ngel sfidë në të ardhmen që treguesit financiarë të përdoren nga vendimmarrësit e brendshëm të firmës më shpesh sesa në nivel vjetor dhe të njëjtit të konsiderohen instrument i rëndësishëm i vendimmarrjes menaxheriale. Andaj, sistemi i

raportimit financiar nuk duhet të jetë vetëm nga prespektiva e kontabilitetit financiarë, por edhe për qëllime të kontabilitetit menaxherial (kjo do të përforconte verifikimin e hipotezës 3).

Këtu kryesisht të dhënat duhet të jenë analitike për menaxherin dhe njëkohësisht edhe treguesit financiarë sipas aktivitetit afarist që firma i realizon. Kështu gjatë vendimmarrjes menaxheriale, treguesit financiarë më analitike mund të luajnë edhe më shumë rolë dhe të jenë më të dobishëm. Për shembull, shpërndarja e klientëve sipas periudhës mesatare të arkëtimit (shprehur në % dhe shuma), treguesit financiarë në bazë të aktiviteteve – punëve të ndërtimtarisë si: ndërtimi i shtëpive, apartamente, mureve të ndryshëm, ndërtimi i garazheve etj.

Marrë në përgjithësi trendi është shpresëdhënës në kuptim të rritjes së aktivës së firmës dhe fitimit neto për periudhën e analizuar duke verifikuar njëkohësisht edhe hipotezat bazë të parashtruara.

Punimi në përgjithësi jep përgjigje pyetjeve të parashtruara hulumtuese duke nxjerrë në përfundim gjithashtu se përdorimi i informacionit financiarë (përfshirë këtu treguesit financiarë) është i kufizuar dhe se përdoret rrallë në kohë.

5.2. Kufizimet e studimit dhe hulumtimet e ardhshme

Ky punim magjistrature sigurisht që i ka mangësitë dhe kufizimet e tij. Përdorimi i një metodologjie ende më të avancuar hulumtuese do të jetë e mirëseardhur për studimet e ardhshme në kuadër të kësaj firme ose të ngjashme.

Treguesit financiarë ende më analitike dhe analiza e tyre do të thotë një qasje dhe metodologji ende më e avancuar. Kjo e implikon raportimin e brendshëm financiar të firmës. Gjithsesi që hapat, teknikat dhe metodologjia e përdorur në drejtim të analizës së pasqyrave financiare dhe treguesve financiarë në këtë studim janë të mirënjohur për analistët financiarë. Por, njëkohësisht ky studim – punim magjistrature mund të shërbej edhe për aspekte metodologjike në studimet e ardhshme.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë të kontabilitetit menaxherial dhe e të dhënave përkatëse kontabël më analitike e pamundëson zbatimin e teknikave dhe metodave më të avancuara në këtë drejtim duke pasqyruar kështu një nga kufizimet bazë të këtij punimi magjistrature.

Referencat / Bibliografia:

Abdylmenaf Bexheti, Financat Publike, 2007.

Accounting Ratios – Accountancy: Company Accounts and Analysis of Financial Statements
<http://ncert.nic.in/ncert/l/leac205.pdf> .[Online]

Accounting Ratios: Types of Ratios, <https://www.toppr.com/guides/accountancy/accounting-ratios/types-of-ratios/>. [Online]

Beshir Ciceri, Halit Xhafa, Drejtimi financiar, Tiranë, 2004.

Edward J. McMillan, Not-for-Profit Budgeting and Financial Management, Fourth Edition, June 2010.

Fitim Deari, Parimet e Kontabilitetit financiar, Tetovë, 2007.

Halit Xhafa, Analiza e Pasqyrave financiare, Tiranë, 2005.

Halit Xhafa, Drejtimi Financiar, Tiranë, 2005.

Hana Vimrova, Financial Analysis Tools, from Traditional Indicators through Contemporary Instruments to Complex Performance Measurement and Management Systems in the Czech Business Practice, 16th Annual Conference on Finance and Accounting, ACFA Prague, 2015, 29th May 2015. [Online]

John J. Wild, Financial Accounting Information for Decision, Mc Graw Hill, 2000.

Kung H. Chen dhe Thomas A. Shimerda, (1981), Financial Management: Journal Article, An Empirical Analysis of Useful Financial Ratios, Spring, vol 10, No 1. [Online]

Manoj Shah, Ratio analysis, Module – III, Unit – II, http://content.inflibnet.ac.in/data-server/eacharya-documents/53e0c6cbe413016f234436f6_INFIEP_18/3/ET/18-3-ET-V1-S1__presentation_ra.pdf. [Online]

Maria Berheci, (2008), The Annual Reports and Financial Decisions, Annales Universitatis Apulensis Series Oeconomica, 2008, Vol. 1, Issue 10. [Online]

Pamela Peterson Drake, Frank J. Fabozzi, Analysis of Financial Statement, Third Edition, 2012.

Rufi Osmani, Kontabiliteti Menaxherial për biznes, Tetovë, 2011.

Schönbohm, Avo, (2013), Performance measurement and management with financial ratios: the BASF SE case, Working Paper, No. 72, Hochschule für Wirtschaft und Recht Berlin,

IMB Institute of Management Berlin,
<https://www.econstor.eu/bitstream/10419/74345/1/746339143.pdf>. [Online]

Sotiraq M. Dhano, Kontabiliteti i avancuar, Tiranë, 2005.

Y.A. Babalola dhe F.R. Abiola, (2013), "Financial Ratio Analysis of Firms: A Tool for Decision Making", International Journal of Management Sciences, Vol. 1, Issue 4. [Online]

Закон за данок на добивка, член 1, 2, "Службен весник на Република Македонија". http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0965/Zakon_za_Danok_na_Dobivka_275_od_27_12_2019.pdf. [Online]

_____. <https://www.readyratios.com/sec/industry/C/>. [Online]

_____. Raportet vjetore dhe të dhënat/informacionet e siguruar nga firma "Meti – Komerc".

_____. <https://www.metikomerc.com/>.

SHTOJCAT:

A. Pyetësi

Pyetësor për temën e magjistraturë: “Analiza e treguesve financiar si mjet për marrjen e vendimeve menaxheriale: Rasti i firmës “Meti-Komerc” për periudhën 2012-2016” përgatitur nga Flora Imeri

1. Cili është niveli juaj i arsimimit?

- a) Ulët
- b) Mesëm
- c) Lartë
- d) Tjetër (shëno) _____

2. Cili është profesioni juaj?

- a) Ekonomist
- b) Inxhinier
- c) Jurist
- d) Tjetër (shëno) _____

3. Cila është detyra/pozita aktuale në firmën “Meti-Komerc”?

- a) Pronar
- b) Menaxher
- c) Udhëheqës departamenti/reparti
- d) Shitës
- e) Tjetër (shëno) _____

4. Cila është përvoja juaj në firmën “Meti-Komerc”?

- a) më pak se 1 vit
- b) 1-5 vite
- c) Më tepër se 5 vite

5. A jeni të informuar për konceptin “kontabilitet”?

- a) Po
- b) Jo

6. A keni pasur rast të lexoni apo përdorni bilancet e firmës “Meti-Komerc”?

- a) Po
- b) Jo

7. Si pjesë e ekipit menaxhues “Meti Komerc” a jeni i vetëdijshëm për përparësitë që analiza e treguesve financiarë ka në vendimmarrjen afariste?

- a) Po
- b) Jo

8. Si pjesë e ekipit menaxhues “Meti Komerc” a e keni përdorur analizën e treguesve financiarë si mjet në vendimmarrjen afariste gjatë periudhës 2012-2016 në funksion të përmirësimit të tyre?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nëse po: Pak: 1 herë në vit
- d) Nëse po: Shumë: çdo muaj; çdo tremujor; çdo gjashtëmujorë

9. Si pjesë e ekipit menaxhues a mendoni se gjendja financiare e kompanisë “Meti Komerc” gjatë periudhës 2012-2016 është përmirësuar?

- a) Po
- b) Jo

10. Si pjesë e ekipit menaxhues “Meti Komerc” a mendoni se performanca financiare e kompanisë gjatë periudhës 2012-2016 është përmirësuar?

- a) Po
- b) Jo

Komenti juaj: _____

B. Bilanci i gjendjes 2012 – 2016

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Aktive afatgjata	3,392,535.00	2,768,626.00	2,452,193.00	2,248,998.00	2,003,684.00
Mjete materiale	3,392,535.00	2,768,626.00	2,452,193.00	2,248,998.00	2,003,684.00
Pasuri të patundshme	472,903.00	460,458.00	448,013.00	435,568.00	423,123.00
Objekte të ndërtimit	472,903.00	460,458.00	448,013.00	435,568.00	423,123.00
Pajisje	1,893,622.00	1,382,988.00	979,175.00	705,056.00	208,888.00
Mjetet transportuese	1,026,010.00	925,180.00	1,025,005.00	729,857.00	939,205.00
Mjete, pajisje zyre dhe mobilje	0.00	0.00	0.00	378,517.00	432,468.00
Aktivitet afatshkurtra	5,084,410.00	6,705,609.00	8,556,592.00	9,741,721.00	13,255,007.00
Inventarët	5,060,887.00	6,687,659.00	6,577,007.00	8,839,855.00	9,671,245.00
Inventarizimi i lëndëve të para dhe materialeve	0.00	0.00	32,933.00	32,933.00	32,933.00
Inventarizimi i pjesëve të këmbimit, inventar i vogël	265,937.00	123,487.00	123,487.00	123,487.00	123,487.00
Stoqet e mallrave	4,794,950.00	6,564,172.00	6,420,587.00	8,683,435.00	9,514,825.00
Kërkesa afatshkurtra	5,186.00	0.00	1,293,549.00	873,299.00	3,388,542.00
Kërkesa nga të punësuarit	0.00	0.00	1,293,549.00	644,306.00	3,321,832.00
Kërkesa nga shteti në bazë të taksave, kontributeve, doganave, akcizave dhe detyrimeve të tjera ndaj shtetit (parapagimet)	5,186	0.00	0.00	54,354.00	66,710.00
Kërkesatë tjera afatshkurtra	0.00	0.00	0.00	174,639.00	0.00
Paratë dhe ekuivalentet e sajë.	18,337.00	17,950.00	686,036.00	28,567.00	195,220.00
Mjete materiale	18,337.00	17,950.00	686,036.00	28,567.00	195,220.00
Gjithsej aktiva	8,476,945.00	9,474,235.00	11,008,785.00	11,990,719.00	15,258,691.00
Pasiva					
Kapitali dhe rezervat	5,465,688.00	7,260,308.00	7,831,773.00	8,432,167.00	9,233,126.00
Kapitali kryesor	1,788,714.00	2,828,714.00	2,828,714.00	2,828,714.00	2,828,714.00

Fitimi i akumuluar	3,360,721.00	3,676,974.00	4,431,594.00	5,003,059.00	5,603,453.00
Fitimi për një vit biznesi	316,253.00	754,620.00	571,465.00	600,394.00	800,959.00
Detyrimet	3,011,257.00	2,213,927.00	3,177,012.00	3,558,552.00	6,025,565.00
Detyrimet afatshkurtra	3,011,257.00	2,213,927.00	3,177,012.00	3,558,552.00	6,025,565.00
Detyrimet ndaj furnitorëve	1,456,422.00	1,122,558.00	500,979.00	1,632,532.00	2,129,044.00
Detyrime për paradhënie, depozita dhe kredi	115,509.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Detyrime për tatimet dhe kontributet e pagave	40,980.00	91,046.00	46,013.00	33,597.00	29,868.00
Detyrime ndaj të punësuarve	95,110.00	206,656.00	104,198.00	77,157.00	67,936.00
Detyrime tatimore aktuale	44,017.00	177,667.00	197,972.00	24,780.00	225,726.00
Detyrime ndaj huave dhe huave ndaj kompanive të ndërlidhura.	0.00	0.00	1,491,546.00	0.00	0.00
Kredi dhe huat	1,116,000.00	616,000.00	616,000.00	1,591,253.00	2,261,000.00
Detyrime të tjera	143,219.00	0.00	220,304.00	199,233.00	1,311,991.00
Pasiva gjithsej	8,476,945.00	9,474,235.00	11,008,785.00	11,990,719.00	15,258,691.00

C. Bilanci i suksesit 2012 – 2016

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat operative	15,799,199.00	15,932,944.00	20,891,326.00	22,465,936.00	21,715,984.00
Të ardhurat nga shitja	15,799,199.00	15,932,944.00	20,891,326.00	22,465,936.00	21,715,984.00
Shpenzimet operative	15,482,946.00	15,178,324.00	20,146,714.00	21,730,994.00	20,736,568.00
Shpenzime për lëndët e para dhe materialet tjera	918,826.00	1,249,431.00	1,604,201.00	984,804.00	672,008.00
KMSH	12,666,174.00	11,511,967.00	16,176,057.00	18,518,280.00	17,560,947.00
Shpenzimet e materialeve	239,493.00	0.00	0.00	61,753.00	53,779.00
Shpenzime të tjera Operative	0.00	0.00	0.00	63,828.00	235,433.00
Shpenzimet e të punësuarve	1,658,453.00	1,786,363.00	1,803,204.00	1,520,617.00	1,370,728.00
Pagesat e pagave	1,174,993.00	1,239,936.00	1,250,376.00	1,017,472.00	918,732.00
Shpenzime për shtesat e pagave	40,123.00	50,556.00	51,588.00	47,170.00	50,615.00
Kontributet nga sigurimi social	443,337.00	495,871.00	501,240.00	397,517.00	356,801.00
Shpenzime tjera operative	0.00	0.00	0.00	58,458.00	44,580.00
Amortizimi i aktiveve	0.00	630,563.00	563,252.00	581,712.00	843,673.00
Shpenzimet financiare	0.00	0.00	109,651.00	67,838.00	89,462.00
Shpenzimet e interesit për operacionet me kompani të palidhura	0.00	0.00	109,256.00	67,838.00	87,002.00
Shpenzimet bazuar në ndryshimet në kursin e këmbimit	0.00	0.00	395.00	0.00	2,460.00

Fitimet nga operacionet e rregullta	316,253.00	754,620.00	634,961.00	667,104.00	889,954.00
Fitimet para tatimit	316,253.00	754,620.00	634,961.00	667,104.00	889,954.00
Tatimi mbi të ardhurat	0.00	0.00	63,496.00	66,710.00	88,995.00
Fitimi neto	316,253.00	754,620.00	571,465.00	600,394.00	800,959.00